Raiffeisen
Invest

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid

www.raiffeisen-invest.al

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid

Prospekt

Publikuar në **Tetor 2026**

Raiffeisen Invest

Informacion i rëndësishëm mbi fondin e investimit dhe prospektin e fondit

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid është një sipërmarrje investimesh kolektive me ofertë publike, me pjesëmarrje të hapur, e themeluar nga Raiffeisen Invest sh.a. si Fond furnizues i Fondit Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide (Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid) i administruar nga Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H., me seli në Vienë, Austri.
Raiffeisen Invest sh.a. (në vijim: Shoqëria Administruese), shoqëri administruese e licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (në vijim: 'AMF'), për të administruar fonde të pensionit privat dhe sipërmarrje të investimeve kolektive, e zhvillon aktivitetin e saj me ndershmëri dhe profesionalizëm në interesin më të mirë të investitorëve.

Sipërmarrja e investimeve kolektive me ofertë publike, ose fondi i investimit është një grupim i veçantë asetesh, pa personalitet juridik, i krijuar në bazë të një marrëdhënieje kontraktuale, pas licencimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, dhe i administruar nga shoqëria administruese, me qëllim grumbullimin e aseteve monetare ose të ngjashme, nëpërmjet ofertës publike të kuotave të fondit.
Shoqëria administruese është subjekti juridik qeverisës i fondit të investimit, që e administron dhe e përfaqëson atë në lidhje me palët e treta.

Asetet e fondit investohen në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive". Mbajtësit e kuotave kanë të drejtën jo vetëm të marrin pjesë në mënyrë proporcionale në fitimet e fondit, por edhe të kërkojnë, në çdo kohë, shlyerjen e kuotave që zotërojnë.

Prospekti përmban të gjithë informacionin e nevojshëm, në mënyrë që investitorët potencialë të jenë në gjendje të vlerësojnë objektivat dhe strategjitë kryesore të Fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid (në vijim: Fondi Furnizues), risqet specifike të lidhura me investimin në fond, profilin e investitorëve të përshtatshëm, si dhe tarifat dhe pagesat e Fondit Furnizues.

Shoqëria administruese konfirmon që ky Prospekt përmban të gjithë informacionin e konsideruar thelbësor në kontekstin e objektivit të investimit dhe deklaron që ka treguar të gjithë kujdesin e nevojshëm që informacioni që përmban ky Prospekt, të jetë në përputhje me faktet, dhe që nuk ka përjashtime faktesh që mund të ndikojnë mbi domethënien e tij.

Informacioni i dhënë në këtë Prospekt është shprehur ndershmërisht, për të orientuar investitorët. Çdo opinion ose parashikim i përmendur nuk ka për qëllim keqinformimin e investitorit. Janë kryer të gjitha kërkimet e duhura për të konstatuar dhe verifikuar për sa më sipër.

Prospekti nuk përbën një ftesë për të blerë kuota të Fondit Furnizues por shërben si mjet informues lidhur me tiparet, karakteristikat dhe risqet e lidhura me pjesëmarrjen në këtë Fond.
Investitorët potencialë kështillohen të lexojnë këtë Prospekt në mënyrë që të kenë një informacion të qartë mbi karakteristikat dhe risqet e Fondit Furnizues përpara se të marrin vendimin për të investuar.

Pasqyra e lëndës

	Përkufizime të termave kryesorë	**7**
1	**Shoqëria administruese**	**11**
1.1	Forma ligjore	11
1.2	Fondet nën administrim	11
1.3	Organet drejtuese të shoqërisë administruese	11
1.3.1	Asambleja e aksionarëve	11
1.3.2	Këshilli i administrimit	12
1.3.3	Administratorët	13
1.3.4	Personeli kyç i shoqërisë	13
1.4	Delegimi i disa funksioneve të shoqërisë administruese tek palët e treta	13
1.4.1	Delegimi i disa funksioneve tek Raiffeisen Bank sh.a.	13
1.4.2	Konflikti i interesit nga delegimi i funksioneve	14
2	**Informacion i përgjithshëm mbi fondin kryesor**	**15**
2.1	Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid (emri origjinal në gjermanisht: Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide)	15
2.2	Data e krijimit të fondit kryesor dhe kohëzgjatja	15
2.3	Qëllimi i investimit dhe politika e investimit e fondit kryesor	15
2.3.1	Qëllimi i investimit dhe politika e investimit	15
2.3.2	Kriteret mjedisore dhe/ose sociale	17
2.3.3	Teknikat dhe instrumentet e politikës së investimit	19
2.4	Profili i riskut i fondit kryesor	20
2.4.1	Informacion i përgjithshëm	20
2.4.2	Risku i qëndrueshmërisë	20
2.4.3	Mjetet e menaxhimit të likuiditetit	21
2.4.4	Risqe specifike	21
2.4.5	Risqe të përgjithshme & përkufizime	23
2.5	Marrja e dokumentacionit të rëndësishëm të fondit kryesor	26
2.6	Tarifat e fondit kryesor	26
2.7	Pasojat fiskale të investimeve në kuotat e fondit kryesor	26
2.8	Përmbledhje e marrëveshjes së lidhur midis dy shoqërive administruese të fondeve	27
3	**Informacion i përgjithshëm mbi fondin furnizues**	**28**
3.1	Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid	28
3.1.1	Mjetet e menaxhimit të likuiditetit	28
3.2	Data e krijimit të fondit, kohëzgjatja dhe monedha	28
3.2.1	Të dhëna historike	29
3.3	Qëllimi i investimit dhe politika e investimit	29
3.3.1	Qëllimi i investimit	29
3.3.2	Politika e investimit	29
3.3.3	Profili i investorit	30

3.4	Profili i riskut i fondit furnizues	30
3.4.1	Risqe që lidhen me investimin	30
3.4.2	Risqe që lidhen me shoqërinë administruese	31
3.4.3	Risqet që ndikojnë te investitorët dhe shoqëria administruese	32
3.5	Shuma minimale e investimit	32
3.6	Të drejtat dhe detyrimet nga kuotat	32
3.7	Mënyra dhe kushtet e blerjes apo shlyerjes së kuotave	33
3.7.1	Blerja e kuotave në fond	33
3.7.2	Shlyerja e kuotave	34
3.8	Këmbimi i kuotave	34
3.9	Transferimi i kuotave të fondit	34
3.10	Pezullimi i shitjes dhe i shlyrjes së kuotave në një fond investimi	35
3.11	Administrimi i pjesës së fitimit për mbajtësit e kuotave	35
3.12	Metodologjia dhe frekuenca e vlerësimit të aseteve dhe çmimit për kuotë	35
3.13	Informimi i investitorëve	37
3.14	Likuidimi, mbyllja e fondit kryesor dhe fondit furnizues	37
3.14.1	Likuidimi, mbyllja dhe bashkimi i fondit kryesor	37
3.14.2	Likuidimi dhe mbyllja e fondit furnizues	37
3.14.2.1	Kërkesa për likuidimin vullnetar të fondit furnizues	38
3.14.2.2	Procedurat e likuidimit vullnetar dhe mbylljes së fondit furnizues	38
3.15	Tarifa dhe komisione	38
3.15.1	Komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit	38
3.15.2	Komisione/tarifa që paguhen nga asetet e fondit	39
3.15.3	Komisione/tarifa që paguhen nga mbajtësit e kuotave (investitori)	39
3.16	Trajtimi fiskal i fondit furnizues dhe investitorit	40
3.17	Viti financiar	40
3.18	Audituesi i jashtëm	40
4	**Depozitari i fondit**	**41**
4.1	Konflikti i interesit	42
5	**Informacion plotësues**	**43**
5.1	Etika dhe konflikti i interesit	43
5.2	Kujdesi	43
5.5	Ankesat	43
5.6	Ekzekutimi optimal i vendimeve të tregtimit	44
5.6.1	Kriteret e ekzekutimit	44
5.6.2	Përzgjedhja e ndermjetësve/ palëve	44
5.6.3	Vendet e ekzekutimit	44

Aneksi 1	**Rregullat e Fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid**	**45**
Aneksi 2	**Deklarata e kujdestarisë**	**49**
Aneksi 3	**Formular tip i blerjes së kuotave në Fondin e Qëndrueshëm Raiffeisen Solid**	**50**

Përkufizime të termave kryesorë

Për qëllimet e këtij Prospekti, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

AMF: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare

Aksione: Tituj të transferueshëm që përfaqësojnë një pjesë të pronësisë së investitorit në një shoqëri tregtare, me pritshmëri marrjen e një pjese të fitimeve në formën e dividendëve, ose të përfitimit nga rritja e çmimit të aksioneve të saj, ose të dyja.

Asete: tituj, instrumente të tregut të parasë, para dhe pasuri të tjera, të cilat janë në pronësi të sipërmarrjes së investimeve kolektive.

Depozitari: bankë e nivelit të dytë, e licencuar nga Banka e Shqipërisë, për të ofruar shërbime kujdestarie, depozitimi dhe të besimit si dhe nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, për të ofruar shërbime depozitimi për sipërmarrjet e investimeve kolektive.

Diversifikimi i portofolit: investim i aseteve të Fondit në instrumente të ndryshme financiare, në mënyrë që të zvogëlohet risku nga investimi.

Direktiva 2009/65 / KE: Direktiva e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 13 korrik 2009 për koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me sipërmarrjen e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT).

Dita e Tregtimit: është periudha gjatë një ditë pune, gjatë së cilës Shoqëria Administruese është e hapur për të ushtruar veprimtarinë në përputhje me dispozitat e këtij prospekti.

FATCA: ligj federal i SHBA, i cili u kërkon të gjithë institucioneve financiare të huaja t'i raportojnë Agjencisë së të Ardhurave në SHBA (IRS) informacionin mbi llogaritë financiare të taksapaguesve amerikanë, ose të entiteteve të huaja në të cilat taksapaguesit amerikanë zotërojnë një përqindje të rëndësishme.

Fond investimi: sipërmarrje e investimeve kolektive e themeluar si fond kontraktor, me objekt të vetëm sigurimin e kapitalit nga investitorët dhe investimin e këtij kapitali në lloje të ndryshme investimesh, sipas një politike të miratuar për investimet, me qëllim realizimin e përfitimeve për mbajtësit e kuotave të fondit të investimeve.

Fond i tregtuar në bursë (ETF): sipërmarrja e investimeve kolektive që ndjek një indeks, sipas të cilit tregtohet gjatë gjithë ditës një klasë kuotash ose aksionesh në një platformë tregtimi dhe me një krijues tregu, i cili garanton që çmimi i kuotave ose aksioneve të tij në treg nuk ndryshon ndjeshëm nga vlera neto e aktiveve dhe, sipas rastit, nga vlera neto orientuese e aktiveve. Fondi i tregtuar në bursë ngjason me sipërmarrjen e investimeve kolektive (SIK), megjithatë, në ndryshim nga SIK është i listuar në bursë dhe tregtohet gjatë gjithë ditës ashtu si aksionet e zakonshme dhe çmimi i tij luhatet gjatë ditës.

Fond Furnizues: sipërmarrja e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur ose nënfondi i saj që investon jo më pak se 85% të aseteve të veta në një tjetër sipërmarrje të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur ose në një nën-fond, që është fondi Kryesor.

Fondi Kryesor: sipërmarrja e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur ose një nënfond i një sipërmarrjeje të investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur, e cila ka të paktën një sipërmarrje furnizuese ndër pjesëmarrësit e saj dhe e cila vetë nuk është sipërmarrje furnizuese dhe nuk zotëron pjesëmarrje në një sipërmarrje furnizuese.

Instrument derivativ: një instrument financiar, vlera e të cilit mbështetet ose rrjedh nga një aktiv tjetër bazë ose grup aktivesh të tjerë. Aktivet kryesore më të zakonshme për derivatet janë aksionet, obligacionet, monedhat, normat e interesit dhe indekset e tregut.

Instrument i të ardhurave fikse: instrument financiar që paguan tek investitorët pagesa të interesit fikse deri në datën e maturimit. Në maturim, investitorët marrin shumën e principalit që kishin investuar. Obligacionet qeveritare dhe të korporatave, si edhe bonot e Thesarit janë llojet më të zakonshme të produkteve me të ardhura fikse. Sidoqoftë, ka fonde të tregtuara në bursë (ETF) dhe sipërmarrje të investimeve kolektive (SIK), të cilat investojnë në produkte me të ardhura fikse.

Investitor: subjekti që ka në pronësi kuota në një fond investimi.

InvFG 2011 (Akti i Fondit të Investimit Austriak): "Akti Federal për Fondet e Investimit të vitit 2011" njihet si Akti i Fondit të Investimit të vitit 2011 (InvFG 2011). Ai rregullon detajet e transaksioneve të fondeve, të kryera në Austri, duke përfshirë regjimin tatimor. Qëllimi kryesor i InvFG 2011 është mbrojtja e investitorit, kjo është arsyeja që mënyrat e sigurimit, të manaxhimit të riskut dhe të kërkesave për dhënien e informacionit paraqiten qartë në Akt (në vijim: Akti Austriak).

Këshilli i Administrimit: duke iu referuar ligjit për shoqëritë tregtare, është i vetmi organ administrimi i shoqërisë aksionare, i cili ushtron njëkohësisht, funksione administrimi e mbikëqyrjeje (sistemi me një nivel drejtimi).

Kthimi nga investimi: fitimi që merret nga investimi i aseteve.

Kohëzgjatja: tregues i ndjeshmërisë së çmimit të një obligacioni (që përfshin interesin e përllogaritur) ndaj ndryshimeve në normat e interesit.

Kohëzgjatja e portofolit: maturiteti mesatar i ponderuar i obligacioneve individuale që përbëjnë portofolin e investimeve.

Kuotë: çdo pjesëmarrje e barabartë përpjesëtimore, që rezulton pas pjesëtimit të interesave përfituese në aktivet, objekt i sipërmarrjes së investimeve kolektive të fondit të investimeve.

Kuota akumulimi: kuotat e një fondi për të cilin të ardhurat nga investimi riinvestohen automatikisht dhe përfitimet për investitorët vijnë nga akumulimi i vlerës së atyre kuotave.

Kriteret mjedisore, shoqërore dhe të qeverisjes: Një grup standardesh të aplikuara nga një kompani ose shtet, në bazë të të cilave investitorët vleresojnë investimet e tyre. Kriteret mjedisore marrin në konsideratë mënyrën se si një kompani ose shtet funksionon si mbrojtës i mjedisit. Kriteret shoqërore shqyrtojnë se si administrohen marrëdhëniet me punonjësit, furnitorët, klientët dhe komunitetet. Qeverisja merret me udhëheqjen e një kompanie, pagesat e bordit ekzekutiv, auditimet, kontrollet e brendshme dhe të drejtat e aksionarëve.

Manaxher i Fondit: personi përgjegjës në shoqërinë administruese për administrimin e portofolit të investimit.

Marrëveshje e riblerjes (Repo): është ajo lloj marrëveshje ku shitësi i titujve, pranon t'i blejë ato përsëri në një kohë dhe me çmim të paracaktuar.

Marrëveshje e anasjelltë e riblerjes (Reverse Repo): blerja e titujve për t'i rishitur ato më pas në një datë të caktuar me një çmim më të lartë.

Ofertë publike: ftesa për të nënshkruar tituj, e cila i drejtohet një numri të papërcaktuar personash, nëpërmjet mjeteve të komunikimit masiv.

Periudha minimale e investimit: periudha e investimit fillon në momentin e blerjes së kuotave të fondit, dhe zgjat deri në momentin e mbërritjes në Raiffeisen Invest të një kërkese të vlefshme për shitjen e kuotave.

Portofol Investimi: tërësia e investimeve të kryera me asetet e fondit.

Prospekt: dokumenti i bërë publik, që përmban informacionin më të rëndësishëm për sipërmarrjen e investimeve kolektive, si politika e investimit, politika e administrimit të riskut, tarifat etj

Rabat: pjesa e tarifës së administrimit që i kthehet Fondit Furnizues nga Fondi Kryesor.

Raiffeisen INVEST: Shoqëria administruese e Fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid, Fond Furnizues.

Rregullat e Fondit: dokumenti kryesor që rregullon marrëdhënien ligjore midis Shoqërisë Administruese dhe mbajtësve të kuotave në Fond.

Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H.: Shoqëria Administruese e fondit Kryesor të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid (emri origjinal në Gjermanisht: Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide), është e licencuar nga Autoriteti Austriak për Tregjet Financiare.

Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide: Fondi Kryesor i administruar nga Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H.

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid: Fondi Furnizues i administruar nga Raiffeisen Invest sh.a., Shoqëri Administruese e licencuar nga AMF.

Sipërmarrje e investimeve kolektive (SIK): personi juridik ose bashkimi i posaçëm i aseteve të investitorëve, që funksionon në formën e fondit të investimit ose shoqërisë së investimit.

Sipërmarrje e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm (SIKTT): Fondet SIKTT regjistrohen në Europë dhe u shiten investitorëve në mbarë botën duke përdorur rregullore dhe kritere të unifikuara për mbrojtjen e investitorit. Kuadri rregullativ i Komisionit Europian mundëson një administrim të koordinuar në të gjithë Europën për manaxhimin dhe shitjen e këtyre fondeve.

Sipërmarrje me pjesëmarrje të hapur: sipërmarrja e cila në bazë të dokumentit themelues shlyen pjesëmarrjet çdo ditë pune, sipas një çmimi të llogaritur në bazë të vlerës neto të aktiveve për pjesëmarrje të sipërmarrjes, të përcaktuar në përputhje me ligjin.

Sipërmarrje e veçantë: sipërmarrja e investimeve kolektive që nuk është sipërmarrje ombrellë ose nënfond.

Standardi i Përbashkët i Raportimit (CRS): përbën një kërkesë rregullatore për raportim për Institucionet Financiare të vendosura në juridiksionet pjesëmarrëse dhe ka qëllimin për të shmangur evazionin fiskal.

Sipërmarrje e huaj e investimeve kolektive: një sipërmarrje e investimeve kolektive, e krijuar sipas legjislacionit të një shteti tjetër përveç Republikës së Shqipërisë.

Shkëmbimi automatik i informacionit për llogaritë financiare (AEIFA): Ligji nr.4, miratuar nga Kuvendi i RSH në 30/01/2020.

Shoqëria administruese: shoqëri aksionare e themeluar në përputhje me ligjin shqiptar për shoqëritë tregtare dhe e licencuar nga AMF, për të administruar fonde pensioni dhe/ose sipërmarrje të investimeve kolektive bazuar në ligjin për SIK.

Shuma minimale e mbetur në fond: vlera minimale e llogarisë në fond, nën të cilën llogaria mund të mbyllet.

Shtet anëtar i ZEE-së: Shtete Anëtare të Zonës Ekonomike Europiane.

Titull: instrument financiar i negociueshëm që emetohet dhe tregtohet për sigurimin e fitimit, nëpërmjet administrimit të të drejtave që rrjedhin nga zotërimi i tij. Mund të jetë titull i pjesëmarrjes në kapital, titull borxhi, aksion dhe kuota të fondit të investimeve ose fondit të pensioneve.

Titull borxhi "Me gradë investimi": titull me një vlerësim të cilësisë së kredisë të paktën BBB- nga Standard & Poor's ose vlerësime ekuivalente të kreditit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht. Këto tituj përfaqësojnë një risk relativisht të ulët të mospagimit.

Titull borxhi "Nën gradë investimi": titull me një vlerësim të cilësisë së kredisë nën BBB- nga Standard & Poor's ose vlerësime ekuivalente të kreditit nga vlerësues të tjerë ndërkombëtarë të njohur gjerësisht. Këto tituj paguajnë norma më të larta interesi sepse kanë vlerësim më të ulët të cilësisë së kredisë sesa titujt "Me gradë investimi".

Treg i rregulluar: sistemi shumëpalësh që shfrytëzohet dhe/ose administrohet nga një subjekt operator tregu, i cili bashkon ose ndihmon në bashkimin e interesave të shumta të shitblerjes që kanë të tretët për instrumente financiare, në përputhje me rregulloret e detyrueshme të tij. Instrumentet financiare pranohen për tregtim sipas rregulloreve dhe/ose sistemeve të tregut të rregulluar dhe ai licencohet, regjistrohet ose njihet nga autoriteti. Ky përkufizim përfshin gjithashtu tregjet mbi banak, ku titujt janë emetuar dhe garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë me kusht që shitja të njihet dhe të rregullohet nga autoriteti, si dhe të jetë e hapur ndaj publikut.

Tregu i aksioneve: është një treg në të cilin emetohen dhe tregtohen aksione, përmes pjesëmarrjes në tregun e aksioneve, apo në tregjet mbi banak (OTC). Tregu i aksioneve është një nga fushat më jetësore të ekonomisë së tregut sepse u jep kompanive mundësinë të rrisin kapitalin, dhe investitorëve mundësinë për të zotëruar një pjesë të pronësisë së një kompanie me potencial për të realizuar përfitime, bazuar në performancën e saj të ardhshme.

Tregu i parasë: Tregu i parasë i referohet tregtimit në instrumente borxhi afatshkurtra.

Tarifa e daljes: komisioni që investitori paguan në momentin e shlyerjes së kuotave të fondit të investimit.

Vlera neto e aseteve: vlera e agreguar e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive pas zbritjes së shumës totale të detyrimeve të sipërmarrjes së investimeve kolektive në momentin e llogaritjes.

Vlera neto e aseteve për kuotë: vlera neto e aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, e pjesëtuar me numrin e kuotave në emetim në çastin e llogaritjes së vlerës neto të aktiveve.

Vlerësim i titujve të borxhit: renditje e titujve, e kryer nga agjencitë ndërkombëtare të klasifikimit, sipas nivelit të riskut që lidhet me investimin në to dhe kthimin nga investimi. Sipas Agjencisë Standard & Poor's, titujt e borxhit afatgjatë të klasifikuar në intervalet AAA deri BBB- (tituj me gradë investimi) përfaqësojnë risk më të ulët e për rrjedhojë pritshmëria për kthimin nga investimi është më e ulët. Titujt e borxhit të klasifikuar në intervalet BB+ deri D (tituj me nën gradë investimi) përfaqësojnë risk të lartë, e për rrjedhojë kanë kthimin e pritshëm nga investimi më të lartë.

1 Shoqëria administruese

1.1 Forma ligjore

Raiffeisen Invest sh.a. – Shoqëria administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe SIK, është një shoqëri aksionare, me seli në Rr.Abdyl Frashëri, EGT Tower, Pall.11/1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri. Aksionari i vetëm i shoqërisë është Raiffeisen Bank sh.a., e cila zotëron 100% të aksioneve. Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 90.000.000 (nëntëdhjetëmilionë) lekë.

Raiffeisen Invest sh.a mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", Ligjit nr. 76/2023 "Për fondet e pensionit Privat" dhe Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive".

Raiffeisen Invest ka si objekt të aktivitetit të saj:

- Veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat dhe aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën me nr.1, datë 13.12.2011, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.
- Shoqëria Administruese, gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj vepron me ndershmëri dhe paanësi, me aftësinë dhe kujdesin e duhur, duke zbatuar kuadrin ligjor në fuqi, rregullat profesionale dhe praktikat më të mira.
- Shoqëria administruese është subjekti juridik qeverisës i të gjithë fondeve nën administrimin e saj, si dhe përfaqësuesi i tyre në lidhje me palët e treta.

1.2 Fondet nën administrim

Raiffeisen INVEST sh.a. administron fondet e mëposhtme:
1. Fondin e investimit Raiffeisen Prestigj
2. Fondin e investimit Raiffeisen Invest Euro
3. Fondin e investimit Raiffeisen Vizion
4. Fondin e investimit Raiffeisen Miks
5. Fondin e Pensionit me Pjesëmarrje të hapur Raiffeisen
6. Fondin Furnizues të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid

1.3 Organet drejtuese të shoqërisë administruese

Organet drejtuese të shoqërisë administruese janë: Asambleja e aksionarëve, Këshilli i Administrimit, dhe Administratorët.

1.3.1 Asambleja e aksionarëve

Asambleja e aksionarëve përbëhet nga përfaqësuesit ligjorë të aksionarit të vetëm të shoqërisë - Raiffeisen Bank sh.a.

1.3.2 Këshilli i administrimit

Këshilli i administrimit është organi qendror i shoqërisë administruese, i cili kontrollon dhe mbikëqyr zbatimin e politikave tregtare dhe zhvillimin e biznesit të shoqërisë administruese. Ai kujdeset që shoqëria administruese të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit, miraton politikat tregtare dhe financiare, të investimit, prospektet e fondeve, etj. Këshilli përbëhet si më poshtë:

Znj. Donalda Gjorga: Kryetare e Këshillit të Administrimit
Znj. Donalda Gjorga është aktualisht Drejtore e Departamentit të Thesarit në Raiffeisen Bank.
Znj.Gjorga ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare (MBA) në fushën e Administrimit të Biznesit pranë Fakultetit Ekonomik Tiranë. Donalda ka një eksperiencë në sistemin bankar që nga viti 2002, dhe në fushën e investimeve në tregjet financiare pranë Departamentit të Thesarit në Raiffeisen Bank që nga viti 2004. Znj. Gjorga ka përfunduar me rezultate maksimale testet finale të mbrojtjes së çertifikatave: ACI Dealing dhe ACI Diploma të ofruar nga Financial Market Association, që është shoqata më e madhe ndërkombëtare e traders në tregjet financiare.

Z. Peter Zilinek: Nënkryetar i Këshillit të Administrimit
Z. Peter Zilinek ka një eksperiencë të gjerë në industrinë e manaxhimit të aseteve. Aktualisht ai mban pozicionin e Drejtuesit të Grupit në Departamentin e EQL në Raiffeisen Capital Management, Vienë, Austri. Si pjesë e Qendrës së Kompetencës për Manaxhimin e Aseteve në Raiffeisen Bank International (RBI), ai përfaqëson RBI në këshillat mbikëqyrëse të shoqërive që manaxhojnë fondet e investimeve dhe pensioneve në shumë vende të Europës Qendrore dhe Lindore.
Z. Zilinek ka diplomë masteri respektivisht në manaxhim financiar dhe juridik si dhe është mbajtës i titullit CFA.

Znj. Elona Llaci: Anëtare e Këshillit të Administrimit
Znj. Elona Llaci është Drejtore e Departamentit të Strategjisë dhe Inovacionit pranë Raiffeisen Bank, Shqipëri. Ajo ka një eksperiencë që nga viti 2005 në sektorin Bankar duke mbuluar role të ndryshme si, Financime Projektesh, Vlerësim të Riskut të Kredive Korporate, Anëtare e Komitetit të Kredisë në Bankën Raiffeisen. Znj. Llaci ka njohuri të gjera në industri, ekspertizë për t'u orientuar përkundrejt sfidave të ndryshme që vijnë nga një mjedis dinamik biznesi, sikurse ka eksperiencën e nevojshme për të menaxhuar me sukses objektivat e organizatës, duke përqasur zgjidhje inovative me qëllim arritjen e rezultateve të larta. Znj. Llaci është diplomuar në 2004 në degën Financë / Kontablitet pranë Universtitetit të Tiranës, sikurse është një Manaxhere Inovacioni e certifikuar nga Global Innovation Management Institute.

Znj. Juela Ahmeti: Anëtare e Këshillit të Administrimit
Znj. Juela Ahmeti është diplomuar për Financë/Bankë në Fakultetin e Ekonomisë në Universitetin e Tiranës në vitin 2000. Ajo ka një eksperiencë të gjatë në sistemin bankar, në fushën e financës dhe kontabilitetit, raportimit financiar dhe rregullator. Znj. Ahmeti ka një karrierë që nga viti 2005 në Raiffeisen Bank, ku ka drejtuar departamentet e Kontrollit Financiar & Buxhetimit, Inteligjencës së Biznesit dhe Analizës Financiare. Që nga muaji Gusht 2020, Znj. Juela Ahmeti është Drejtuese e Divizionit të Financës në Raiffeisen Bank, Shqipëri. Nga 1 Korrik 2024 është anëtare e Këshillit të Administrimit të Raiffeisen Invest sh.a.

Znj. Edlira Konini: Anëtare e Këshillit të Administrimit
Znj. Edlira Konini ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare (grada Master) në Paris, Francë, në degën e Administrim Biznesit. Ajo ka një eksperiencë të gjatë në fushën e investimeve dhe tregjeve financiare, që nga viti 2005. Edlira ju bashkua Raiffeisen Invest në vitin 2009, pas një përvoje disa vjeçare si trader në sektorin e Forex-it pranë departamentit të Thesarit dhe Bankingut të Investimeve të Raiffeisen Bank, Shqipëri duke mbajtur fillimisht pozicionin e drejtores së menaxhimit të portofolit e më pas atë të zv. Administratorit të Përgjithshëm. Ka marrë me rezultate të shkëlqyera certifikatën ACI Dealing, të ofruar nga Financial Market Association.

Znj. Elsa Kristo: Anëtare e Këshillit të Administrimit
Znj. Elsa Kristo ka kryer studimet universitare dhe pasuniversitare (grada Doktor i Shkencave) në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës. Ajo gjithashtu mban titullin ndërkombëtar Certified Fraud Examiner (CFE). Ka një eksperiencë të gjatë bankare, më së shumti në Divizionin e Auditimit të Brendshëm në Raiffeisen Bank, ku që prej 2009 ka mbajtur pozicionin e Drejtores së Departamentit të Auditit të Brendshëm per Retail dhe Rrjetin e Degëve. Paralelisht është dhe pedagoge e jashtme në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Tiranës. Në Tetor 2025, iu bashkua Raiffeisen Invest Albania si Zëvendës Administratore e Përgjithshme.

1.3.3 Administratorët

Administratorët e shoqërisë janë njëkohësisht edhe anëtarë të Këshillit të Administrimit. Ata manaxhojnë dhe organizojnë aktivitetin e shoqërisë administruese, përgatisin dhe i propozojnë Këshillit të Administrimit të gjitha procedurat dhe rregulloret e brendshme, vendosin mbi të drejtat, detyrimet e përgjegjësitë e çdo punonjësi, etj.

Administratorët janë:
1. Znj. Edlira Konini – Administratore e Përgjithshme
2. Znj. Elsa Kristo – Zëvendës Administratore e Përgjithshme

1.3.3 Personeli kyç i shoqërisë

Personeli kyç i shoqërisë administruese ka përbërjen e mëposhtme:
1. Z. Lizandër Saraci - Drejtor i Departamentit të Manaxhimit të Riskut
2. Znj. Rezarta Arapi - Drejtore e Departamentit të Manaxhimit të Fondeve
3. Znj. Brunilda Haxhimihali (Emini) - Drejtore e Departamentit Ligjor, Përputhshmërisë & PPP

Personeli kyç nuk ushtron asnjë funksion drejtues në shoqërinë mëmë apo shoqëri tjetër pjesë e grupit financiar.

1.4 Delegimi i disa funksioneve të shoqërisë administruese tek palët e treta

1.4.1 Delegimi i disa funksioneve tek Raiffeisen Bank sh.a.

Me qëllim rritjen e efiçencës dhe shfrytëzimin e sinergjive brenda grupit Raiffeisen, disa funksione të shoqërisë administruese i janë deleguar Raiffeisen Bank sh.a. Mbështetur në eksperiencën dhe standardin e ushtrimit të veprimtarisë nga Raiffeisen Bank sh.a., delegimi është në interesin më të mirë të investitorëve, por shoqëria administruese mbetet përgjegjëse për funksionet e deleguara dhe mbarëvajtjen e tyre.

Raiffeisen Bank sh.a., në bazë të marrëveshjeve të shërbimit të lidhura me shoqërinë administruese ka marrë përsipër kryerjen e plotë ose të pjesshme të funksioneve të mëposhtme:

- Burimet njerëzore: mbështet shoqërinë administruese lidhur me politikat e trajnimeve të punonjësve në përputhje me standardet e Grupit,si dhe politikat e brendshme të saj (Manuali i Personelit, Kodi i sjelljes etj);

- Marketingu dhe Marrëdhëniet me Publikun: zhvillon dhe implementon strategjinë e marketingut të shoqërisë administruese, siguron mbështetjen e duhur për fushatat e komunikimit dhe promovimit të imazhit në përputhje me standardet e Grupit, si dhe mban marrëdhëniet me palët e treta që ofrojnë shërbime të Marketing-ut dhe Marrëdhënieve me Publikun;

- Shitja dhe Shpërndarja: kryen procesin e shitjes së kuotave të fondit në rolin e agjentit të shitjes të shoqërisë adminsitruese;

- Risku operacional: këshillon dhe udhëzon lidhur me politikat e manaxhimit të riskut operacional sipas standardeve të Grupit, vlerësimit të risqeve dhe përcaktimit të indikatorëve paralajmërues të riskut, trajnime për punonjësit etj;

- Auditimi i brendshëm: kryen funksionin e plotë të auditimit të brendshëm nëpërmjet kontrolleve të vazhdueshme të cilat sigurojnë përputhshmërinë e aktivitetit dhe procedurave, me kuadrin ligjor dhe standardet e Grupit, si dhe identifikimin e problematikave dhe ekspozimin ndaj risqeve me qëllim përmirësimin e sistemit të kontrolleve; Auditi i brendshëm raporton në organet drejtuese të shoqërisë administruese;

- Manaxhimi i arkivës dhe disa funksione administrimi;

- Teknologjia e informacionit: mbështet shoqërinë administruese lidhur me zhvillimet hardware dhe software, ndërmarrjen e masave mbrojtëse përfshirë back up të të dhënave dhe rikuperimin e sistemit, mirëmbajtjen e serverave dhe zhvillimin e arkitekturës së tyre, dizenjimin dhe mirëmbajtjen e procedurave të rikuperimit të sistemeve në rast katastrofash etj;

- Siguria: kryen shërbimet e sigurisë së informacionit, sigurisë fizike si dhe shërbime të vazhdimësisë së biznesit. Ofron trajnime lidhur me këto shërbime;

- Pajtueshmëria, pastrimi i parave, sanksionet financiare dhe parandalimi i mashtrimit: ushtron masat e vigjilencës së duhur për parandalimin e pastrimit të parave, sanksioneve financiare, por edhe për qëllime të zbatimit të kërkesave të FATCA dhe CRS; përcakton standardet për parandalimin dhe manaxhon rastet e mashtrimit dhe krimit financiar;

- Elementët e mbrojtjes së të dhënave: Përcakton standardet dhe drejton procesin e mbrojtjes së të dhënave personale.

1.4.2 Konflikti i interesit nga delegimi i funksioneve

Shoqëria administruese vendos të delegojë disa funksione të aktivitetit të saj në palë të treta duke vënë në plan të parë interesin më të mirë të investitorëve, kjo edhe në rastin kur palë e tretë është shoqëria mëmë.

Çdo palë e tretë që merr përsipër kryerjen e disa funksioneve të deleguara nga shoqëria administruese, është e detyruar të:

1. ndërmarrë masat e nevojshme për identifikimin e konflikteve të interesit;
2. hartojë rregullore dhe procedura të brendshme për të shmangur konfliktet e identifikuara të interesit;
3. njoftojë shoqërinë administruese për çdo konflikt interesash që nuk mund të shmanget.

Për çdo funksion të deleguar informohet Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

2 Informacion i përgjithshëm mbi fondin kryesor

2.1 Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid (emri origjinal në gjermanisht: Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide)

Fondi Kryesor quhet Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide dhe është një fond investimi sipas përcaktimeve të § 2 të Aktit Austriak (UCITS) në përputhje me Direktiven 2009/65/EC (Direktiva Europiane për Sipërmarrjet e investimeve kolektive në tituj të transferueshëm).

Shoqëria administruese e Fondit Kryesor është Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H., e licencuar nga Autoriteti Austriak i Tregjeve Financiare dhe e krijuar në Dhjetor 1985 për një afat të pacaktuar, si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar. Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H., është regjistruar në regjistrin e shoqërive të Gjykatës Ekonomike të Vjenës me numrin e regjistrit të shoqërive 83517w. Selia e shoqërisë është në adresën Mooslackengasse 12, A-1190 Vienë, Austri. Shoqëria e ka vendndodhjen në Austri, njësoj si Fondi Kryesor.

Depozitari i Fondit Kryesor është Raiffeisen Bank International AG, me seli në Am Stadtpark 9, A-1030 Vienë dhe auditor është KPMG Austria GmbH Wirtschaftsprüfungs- und Steuerberatungsgesellschaft, me seli në Porzellangasse 51, A-1090 Vienë.

2.2 Data e krijimit të fondit kryesor dhe kohëzgjatja

Fondi Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide është krijuar me 3 Qershor 2015, për një periudhë të pacaktuar.

2.3 Qëllimi i investimit dhe politika e investimit e fondit kryesor

Shënim: Fondi Kryesor synon të jetë në përputhje me qëllimet e tij të investimit. Sidoqoftë, nuk mund të ketë asnjë siguri se këto qëllime investimi do të përmbushen. Përshkrimi i mëposhtëm nuk pasqyron profilin individual të riskut të një investitori të mundshëm. Ne rekomandojmë që investitorët të marrin këshilla investimi nga ekspertë për të vlerësuar nëse fondi i investimit është i duhur dhe i përshtatshëm për rrethanat e tyre personale.

2.3.1 Qëllimi i investimit dhe politika e investimit

Fondi Kryesor është një fond miks, qëllimi i investimit të të cilit janë të ardhurat e rregullta.
Fondi investon të paktën 85% të aseteve të fondit në investime që përdoren për të përmbushur kriteret mjedisore dhe/ose sociale dhe/ose objektivat e investimeve të qëndrueshme të fondit të investimeve. Për këtë qëllim, fondi investon ekskluzivisht në tituj individualë dhe instrumente të tregut të parasë, të cilat përdoren për të përmbushur kriteret mjedisore dhe/ose sociale dhe/ose objektivat e investimeve të qëndrueshme të fondit Kryesor. Të paktën 55% e aseteve të fondit investohen në investime të qëndrueshme me objektiva mjedisore dhe sociale (por jo në perputhje me Taksonominë e BE-së).

Të paktën 51% e aseteve të Fondit Kryesor investohen drejtpërdrejt në tituj financiarë.

Investimet e Fondit Kryesor në aksione dhe ekuivalentë të aksioneve janë të kufizuara në 30% të aseteve të fondit. Obligacionet dhe instrumentet e tregut të parasë që janë pjesë e portofolit të fondit mund të emetohen nga shtete sovrane, emetues ndërkombëtarë dhe/ose kompani etj. Fondi mund të investojë më shumë se 35% të aseteve në tituj borxhi të emetuar nga qeveritë e shteteve: Austri, Gjermani, Belgjikë, Finlandë, Francë dhe Holandë, me kushtin që investimi në një emetim të vetëm nuk mund të jetë më shumë se 30% e aseteve të fondit dhe të investohet në të paktën 6 emetime titujsh të ndryshëm.

Pas vlerësimit të situatës ekonomike, tregjeve të kapitalit dhe perspektivës së bursave, fondi kryesor, në përputhje me politikën e tij të investimit, do të blejë dhe shesë asetet (tituj financiarë, instrumente të tregut të parasë, depozita pa afat, kuota të fondeve të investimit dhe instrumente financiare) e lejuara nga Akti Austriak dhe rregulloret e tij për fondet. Kështu, do t'i kushtohet vëmendje e veçantë diversifikimit të riskut.

Fondi Kryesor mund të investojë në kuota të fondeve të investimit, të cilat kanë kufizime investimi dhe/ose strategji të investimit që ndryshojnë nga ato të fondit Kryesor. Në veçanti, këto devijime mund të lidhen me strategjinë e investimit, përdorimin e instrumenteve të investimit (tituj financiarë, instrumente të tregut të parasë, kuota të fondeve të investimit, instrumente derivative, depozitat me ose pa afat) si dhe me kreditë afatshkurtra, titujt e huazuar dhe marrëveshjet e riblerjes. Por kjo nuk do të ndikojë në ndryshime të rëndësishme të profilit të riskut të fondit. Kuotat e fondeve të investimeve (SIKTT, SIK) mund të arrijnë deri në vlerën 10% të aseteve të fondit për një fond të vetëm - dhe deri në 10% të aseteve të fondit në total - për aq kohë sa këto SIKTT ose SIK nuk investojnë nga ana e tyre më shumë se 10% të aseteve të tyre në kuota të fondeve të tjera të investimit.

Fondi Kryesor mund të kryejë transaksione me instrumente derivative si pjesë e strategjisë së tij të investimit nëse këto derivativë ndihmojnë në reduktimin e risqeve të investimit dhe manaxhimin efikas të aseteve të fondit. Kjo mund të nënkuptojë, të paktën përkohësisht, një risk të rritur të humbjeve. Risku i përgjithshëm për instrumentet derivative, të cilat nuk përdoren për qëllime mbrojtëse është i kufizuar në 49% të aseteve të fondit.

Investimet në asete të denominuara në monedha të ndryshme nga euro janë të kufizuara në 30% të aseteve totale të fondit. Kur risku i monedhës eliminohet nëpërmjet transaksioneve të mbrojtjes (hedging), këto investime nuk përfshihen në limitin e mësipërm.

Asetet e të njëjtit emetues – duke përjashtuar depozitat bankare dhe investimet në tituj borxhi të emetuara nga Republika e Austrisë ose nga provincat federale të Austrisë ose nga një shtet tjetër anëtar i ZEE-së (Zona Ekonomike Europiane) ose nga një shtet përbërës i një shteti tjetër anëtar të ZEE-së ose nga një organizatë ndërkombëtare e krijuar sipas së drejtës publike në të cilën janë anëtarë një ose më shumë shtete anëtare të ZEE-së – mund të arrijnë deri në 5% të aseteve të fondit.

Asetet e emetuesve që i përkasin të njejtit grup korporativ sipas kuptimit të Aktit Austriak mund të jenë deri në 10% të aseteve të fondit.

Fondi Kryesor mund të blejë tituj financiarë (përfshirë ata me instrumente derivative të integruara) në perputhje me Aktin Austriak. Instrumentet e tregut të parasë mund të përbëjnë deri në 49% të aseteve të fondit. Për më tepër, fondi mund të investojë në obligacione ose tituj të tjerë financiarë të emetuar nga bankat.

Fondi mund të blejë tituj borxhi të papaguara plotësisht ose instrumente të tregut të parasë dhe të drejta nënshkrimi për instrumente të tilla ose instrumente të tjera financiare të papaguara plotësisht.

Blerja e titujve financiarë dhe instrumenteve të tregut të parasë kryhet në përputhje me kriteret e listimit dhe tregtimit në një treg të rregulluar ose një bursë titujsh, sipas Aktit Austriak. Titujt financiarë dhe instrumentet e tregut të parasë që nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara sa më sipër mund të arrijnë deri në vlerën 10% të aseteve totale të fondit.

Fondi Kryesor është në monedhën Euro. Investimet dhe shlyerjet bëhen në Euro.

Fondi Kryesor manaxhohet në mënyrë aktive pa iu referuar një indeksi.

2.3.2 Kriteret mjedisore dhe/ose sociale

Fondi Kryesor promovon kriteret Mjedisore/Sociale dhe, ndërsa nuk ka si objektiv një investim të qëndrueshëm, do të ketë një përqindje minimale prej 55.00% të investimeve të qëndrueshme, me një objektiv mjedisor në aktivitetet ekonomike që nuk kualifikohen si të qëndrueshme nga ana mjedisore sipas Taksonomisë së BE-së, dhe me një objektiv social.

Fondi merr në konsideratë kriteret mjedisore dhe sociale për investime, duke përfshirë në veçanti ndryshimet klimatike, kapitalin natyror dhe biodiversitetin, ndotjen mjedisore dhe mbeturinat, mundësitë e përmirësimit mjedisor (p.sh., teknologjinë e gjelbër dhe energjinë e rinovueshme), burimet njerëzore, përgjegjësinë dhe sigurinë e produktit, lidhjet me grupet e interesit dhe mundësitë e përmirësimit social (p.sh., qasja në kujdesin shëndetësor). Sidoqoftë, qeverisja korporative dhe etika e biznesit janë një parakusht për investimet në tituj /instrumente të tregut të parasë. Nuk ka kufizime për kriteret mjedisore ose sociale.

Si pjesë e Grupit RBI (Raiffeisen Bank International AG), Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H., Shoqëria Administruese e Fondit Kryesor zbaton strategjinë e qëndrueshmërisë së Grupit, e cila është një element thelbësor i politikës së saj të biznesit. Për shoqërinë administruese, qëndrueshmëria shihet si përgjegjësi e korporatës për të arritur suksese ekonomike afatgjata duke respektuar mjedisin dhe shoqërinë.

Qëndrueshmëria në procesin e investimit arrihet përmes integrimit të vazhdueshëm të kritereve mjedisore, shoqërore dhe qeverisëse (ESG). Përveç faktorëve ekonomikë, këtu përfshihen edhe kritere tradicionale si përfitueshmëria, likuiditeti dhe siguria, por edhe faktorë ekologjikë dhe shoqërorë dhe një qeverisje (e mirë) e korporatës. Të gjithë këto faktorë janë integruar në proceset e investimit.

Përfshirja e kritereve ESG ndodh në disa nivele të politikës së investimit:

1. Shmangia dhe përgjegjësia: ka të bejë me vendosjen e kritereve negative (përjashtuese) me qëllimin për të përjashtuar sektorë problematikë dhe/ose kompani dhe shtete (sovrane) që shkelin kriteret e përcaktuara.

2. Mbështetja dhe përforcimi i qëndrueshmërisë: Synon të integrojë analizën kërkimore bazuar në kriteret ESG, në procesin e investimit (sistemi i pikëve ESG) për vlerësimin e kompanive dhe në fund për përzgjedhjen e aksioneve (qasja: më i miri në klasifikim). Kjo zbatohet në mënyrë analoge për shtetet (sovrane) si emetues të titujve të borxhit.

3. Influenca dhe ndikimi: ka të bëjë me "Përfshirjen" si pjesë integrale e një politike investimi të përgjegjshme dhe të qëndrueshme përmes dialogut me kompanitë dhe, në veçanti, ushtrimit të së drejtës së votës.

Bashkimi i të tre elementëve – shmangia, mbështetja dhe mbi të gjitha ndikimi – janë të domosdoshme për manaxhimin e përgjegjshëm dhe aktiv të fondeve të qëndrueshme.

2.3.2.1 Strategjia e investimit / metodat për vlerësimin, matjen dhe monitorimin e kritereve ekologjike dhe shoqërore

Tri shtyllat e qëndrueshmërisë që përbëjnë bazën e çdo vendimmarrjeje investimi janë mjedisi (Environment), shoqëria (Social) dhe qeverisja e përgjegjshme e korporatës (Governance).

Investimi në tituj financiarë individualë
Për investimin direkt në tituj financiarë dhe instrumente të tregut monetar, respektohen parimet e mëposhtme: Qasja e integruar e ndjekur nga Raiffeisen KAG fillon me një analizë të përqendruar në të dhëna dhe informacionin e brendshëm e të jashtëm: Një tregues ESG i korporatave dhe shteteve i zhvilluar nga shoqëria administruese në bazë të të dhënave ESG të brendshme e të jashtme formon qendrën e strategjisë së investimit.

Niveli i parë i analizës: Treguesi Raiffeisen ESG për aksionet e korporatave përqendrohet në vlerësime të brendshme të lidhura me temat e së ardhmes, duke reflektuar një vlerësim të potencialit të sektorëve dhe nënsektorëve nga perspektiva e qëndrueshmërisë. Aktualisht, temat e së ardhmes përfshijnë: energjinë, nfrastrukturën, mallrat, teknologjinë, kujdesin shëndetësor/ushqyerjen/mirëqenien, ekonominë rrethore dhe lëvizshmërinë.

Niveli i dytë i analizës: Kryhet vlerësimi ESG i korporatës. Ky përfshin vlerësime të ndryshme nga partnerë të jashtëm, si psh.: vlerësime nga palët e lidhura, një vlerësim të risqeve ESG, një vlerësim të qeverisjes së korporatës, një vlerësim të polemikave dhe një vlerësim të SDG-ve (SDG-të janë objektiva të zhvillimit të qëndrueshëm, të vendosura nga Kombet e Bashkuara dhe të miratuara unanimisht nga 193 vende, dhe zbatohen gjithashtu nga Qeveria Federale Austriake), si dhe një vlerësim në bazë të kritereve negative të përcaktuara nga shoqëria administruese. Në këtë nivel analize, bëhet një përzgjedhje paraprake e universit të përgjithshëm të investimeve.

Niveli i tretë i analizës: Vlerësimi i angazhimit, i cili përfshin një kombinim të tri dimensioneve:
1. intensiteti dhe forma e angazhimit të një kompanie
2. komunikimi
3. ndikimi i angazhimit të kompanisë

Ky është një vlerësim i zbatimit të objektivave të angazhimit nga kompania.

Kur identifikohen risqe reputacioniale, në kontekstin e procesit të angazhimit, kompania do të përjashtohet nga çdo investim.
Nëse një kompani nuk ka treguar ende angazhim, ajo vlerësohet neutrale. Për qëllim të vlerësimit të shteteve sovrane, Raiffeisen ka zhvilluar Treguesin Raiffeisen Sovereign. Janë identifikuar tema të ndryshme për llogaritjen që përshkruajnë nivelin e qëndrueshmërisë së shteteve sovrane, si në legjislacionin e tyre ashtu edhe në sjelljen e tyre ndaj mjedisit dhe qytetarëve. Në modelin e llogaritjes, këto tema përfaqësohen nga të ashtuquajturit faktorë, ku secili faktor i është caktuar ose kategorisë mjedisore, sociale ose të qeverisjes, ose njërës prej nënkategorive: biodiversitet, zbutje e ndryshimeve klimatike, burime, mbrojtje e mjedisit, nevoja themelore, drejtësi, kapital njerëzor, kënaqësi, institucione, politikë, financë dhe transparencë. Të dhënat nga ofruesit e jashtëm të veprimtarive kërkimore përfshihen gjithashtu në llogaritje. Një portofol shumë i diversifikuar ndërtohet nga kompanitë dhe shtetet e përzgjedhura në bazë të analizave të mësipërme, duke marrë parasysh treguesin ESG, zhvillimin e tij (momentin ESG) dhe aspektet themelore. Gjatë këtij procesi, rëndësi të veçantë i kushtohet cilësisë së kompanisë dhe modelit të biznesit. Një shkallë e lartë e qëndrueshmërisë dhe fuqisë themelore janë të një rëndësie vendimtare për investimet.

Investimi në fonde të menaxhuara nga shoqëria administruese
Kur investohet në kuota të fondeve të investimit, mund të blihen vetëm fondet e investimit që kanë karakteristika mjedisore dhe/ose sociale ose përzgjedhin investime të qëndrueshme (Neni 8 dhe Neni 9 i Rregullores për Raportimin e Informacionit mbi Financën e Qëndrueshme / Rregullores (BE) 2019/2088). Parimet e investimit të drejtpërdrejtë në tituj financiarë të listuara më sipër zbatohen edhe për investime në fondet e shoqërive administruese.

Përzgjedhja e fondeve që nuk menaxhohen nga shoqëria administruese
Për përzgjedhjen e fondeve të investimit nga shoqëri të tjera administruese, do të përdoren të dhëna sasiore, siç janë pikët ESG dhe informacioni mbi sektorët dhe praktikat kontroverse, të ndjekura nga një proces cilësor përzgjedhjeje për fondet e investimit të menaxhuara në mënyrë aktive që përfshin biseda personale me menaxherët. Kur investohet në kuota të fondeve të investimit, mund të blihen vetëm fondet e investimit që kanë karakteristika mjedisore dhe/ose sociale ose përzgjedhin investime të qëndrueshme (Neni 8 dhe Neni 9 i Rregullores për Raportimin e Informacionit mbi Financën e Qëndrueshme / Rregullores (BE) 2019/2088).

Implementimi i "Udhëzimeve mbi emrat e fondeve që përdorin terma ESG ose terma të lidhura me qëndrueshmërinë" të përcaktuara nga Autoritetet Evropian i Titujve dhe Tregjeve (ESMA) më 21 gusht 2024 është një parakusht për investim. Pajtueshmëria me kriteret negative/pozitive të miratuara nga shoqëria admininstruese e nënfondeve përkatëse nuk mund të garantohet pavarësisht kontrollit të rregullt dhe të kujdesshëm.

2.3.3 Teknikat dhe instrumentet e politikës së investimit

Fondi Kryesor investon në përputhje me kufijtë e investimit dhe të emetuesve të përcaktuara në Aktin Austriak, rregullat e fondit dhe në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut. Më poshtë është një përshkrim i përgjithshëm i instrumenteve financiare ku mund të investojë fondi Kryesor.

Tituj, të cilat janë
a) Aksione dhe ekuivalentë të aksioneve,
b) Obligacione dhe tituj të tjerë borxhi,
c) Të gjitha instrumentet e tjera financiare të tregtueshme (p.sh. të drejtat e nënshkrimit) që japin të drejtën për të blerë instrumente financiare sipas kuptimit të Aktit Austriak me anë të nënshkrimit ose shkëmbimit.

Në varësi të plotësimit të kritereve të përcaktuara në Aktin Austriak përfshihen gjithashtu:
1. kuota në fondet e mbyllura në formën e një shoqërie investimi ose një fondi investimi,
2. kuota në fondet e mbyllura në formë kontraktuale,
3. instrumente financiare në përputhje me Aktin Austriak.

Fondi Kryesor mund të investojë në tituj financiarë të cilët janë zyrtarisht të licencuar në një nga bursat austriake ose të huaja, të listuara në shtojcën e prospektit të Fondit Kryesor ose të tregtuara në tregje të rregulluara të listuara në shtojcën e prospektit të Fondit Kryesor, të cilat janë të njohura dhe të hapura për publikun e gjerë dhe funksionojnë në mënyrë të rregullt. Për më tepër, fondi mund të blejë tituj borxhi nga emetime të reja, termat dhe kushtet e emetimit të të cilave përfshijnë detyrimin për të aplikuar për një listim zyrtar në një bursë ose treg të rregulluar, me kusht që listimi i tyre të bëhet jo më vonë se një vit pas ditës së emetimit.

- **Instrumente të tregut të parasë,** të cilat tregtohen normalisht në tregun e parasë, janë likuide, vlera e tyre mund të përcaktohet saktësisht në çdo kohë dhe që plotësojnë kërkesat e përcaktuara në Aktin Austriak.

- **Tituj financiarë dhe instrumente të tregut të parasë të palistuar**
  Një maksimum prej 10% e aseteve të Fondit Kryesor mund të investohet në tituj financiarë ose instrumente të tregut të parasë që nuk janë pranuar zyrtarisht për tregtim në një nga bursat e listuara në shtojcën e rregullave të Fondit Kryesor ose nuk tregtohen në një nga tregjet e rregulluara të specifikuara në shtojcën e rregullave të fondit ose, në rast të emetimit të ri të titujve, nëse nuk pranohen për listim brenda një viti nga emetimi i tyre.

- **Kuota në fonde të tjera investimesh**

- **Instrumente financiare derivative**
  Fondi Kryesor do të përdorë instrumente derivative brenda objektivit të tij të investimit për qëllime mbrojtëse dhe gjithashtu si një instrument aktiv investimi, me qëllim që të reduktojë risqet e investimit ose për një manaxhim efikas të portofolit. Prandaj, përdorimi i instrumenteve derivative mund të rritë riskun e humbjes që lidhet me fondin e investimit. Risku i mospagimit për transaksionet e fondeve të investimeve që përfshijnë derivativë të treguar mbi-banak (OTC) nuk mund të kalojë nivelet e mëposhtme:
  1. nëse pala tjetër është një institucion krediti sipas kuptimit të Aktit Austriak, 10% e aseteve të fondit,
  2. në të kundërt 5 % e aseteve të fondit.

- **Huamarrja**
  Shoqëria Administruese Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H, mund të marrë hua të përkohshme deri në vlerën 10% të aseteve të fondit për llogari të fondit të investimit. Huamarrja do të rrisë nivelin e investimit dhe rrjedhimisht riskun e Fondit Kryesor.

- **Marrëveshjet e riblerjes**
  Shoqëria Administruese Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft mbH lejohet të blejë asete për llogari të fondit të investimit, deri në 100% të aseteve të fondit që janë subjekt i një detyrimi nga ana e shitësit për t'i riblerë ato asete në një kohë të paracaktuar dhe me një çmim të paracaktuar.

Huazimi i titujve financiarë

Brenda kufijve të investimit të përcaktuara nga Akti Austriak, Shoqëria Administruese Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft mbH ka të drejtë t'u transferojë tituj financiarë palëve të treta deri në vlerën 30% të aseteve të fondit brenda kuadrit të një sistemi të pranuar të huadhënies së titujve financiarë dhe për një periudhë të kufizuar, me kusht që pala e tretë të jetë e detyruar të ritransferojë titujt financiarë pas një periudhe të paracaktuar huazimi. Tarifa e përfituar është një burim i shtuar të ardhurash dhe në këtë mënyrë do të përmirësojë performancën e fondit.

2.4 Profili i riskut i fondit kryesor

Fondi Kryesor investon në përputhje me kufijtë e investimit dhe të emetuesve të përcaktuara në Aktin Austriak, rregullat e fondit dhe në përputhje me parimin e diversifikimit të riskut. Më poshtë është një përshkrim i përgjithshëm i instrumenteve financiare ku mund të investojë fondi Kryesor.

2.4.1 Informacion i përgjithshëm

Asetet në të cilat shoqëria administruese e Fondit Kryesor investon për llogari të fondit të investimit sjellin risqe si dhe mundësi të ardhurash. Në qoftë se investitori shet kuota të fondit në një kohë kur çmimet e aseteve kanë rënë, ai nuk do të marrë të gjitha paratë që ka investuar në fondin e investimit. Megjithatë, risku i investitorit është i kufizuar në vlerën e investuar.

Për shkak të strukturave të ndryshme të klasave individuale të kuotave, kthimi i investimit per investitorin mund të ndryshojë sipas klasës së kuotave ku ai ka investuar.

2.4.2 Risku i qëndrueshmërisë

Risku i Qëndrueshmërisë nënkupton ngjarje ose kushte mjedisore, sociale ose të lidhura me qeverisjen e korporatave, që mund të shkaktojnë një ndikim negativ aktual ose potencial material në vlerën e investimit nëse ato ndodhin.

Një aspekt i rëndësishëm i riskut të qëndrueshmërisë përfshin risqet mjedisore dhe reputacionin (p.sh. nëpërmjet thirrjeve për të bojkotuar produktet që shkelin ligjet e punës) që lidhen me kompanitë dhe emetuesit.

Gjatë marrjes së vendimeve për investime, risqet e qëndrueshmërisë shqyrtohen kur vlerësohet raporti risk/përfitim për çdo investim.

Kur investohet në fonde të shoqërive të tjera administruese, qasja e tyre ndaj risqeve të qëndrueshmërisë do të merret në konsideratë. Në veçanti, do të përcaktohet se cilat investime do të përjashtohen nga universi i investimeve për arsye qëndrueshmërie. Përzgjedhja e fondit do t'i nënshtrohet të njëjtit vlerësim, e orientuar nga qëndrueshmëria si faktori vendimtar.

Risku i qëndrueshmërisë vlerësohet dhe monitorohet në mënyrë të pavarur nga departamenti i manaxhimit të riskut të Fondit Kryesor, duke marrë në konsideratë të dhëna të jashtme. Gjatë këtij procesi mund të aplikohen vlerësimet e qëndrueshmërisë (pikët ESG) dhe të dhënat e qëndrueshmërisë (p.sh. emetimet e karbonit).

Ndikimi i risqeve të qëndrueshmërisë në kthimin e fondit.

Përgjithësisht ndikimi i risqeve të qëndrueshmërisë është më i ulët për fondet që marrin në konsideratë kriteret ekologjike dhe sociale gjatë investimit dhe më i lartë për fondet që nuk i marrin në konsideratë këto kritere gjatë investimit.

Fondi Kryesor merr në konsideratë kriteret ekologjike dhe sociale për investimin. Prandaj, shoqëria administruese vlerëson që ndikimi i risqeve të qëndrueshmërisë në kthimin e fondit është i ulët.

Përveç risqeve të qëndrueshmërisë, ka risqe të mëtejshme që janë relevante për fondin siç përshkruhet më poshtë.

2.4.3 Mjetet e menaxhimit të likuiditetit

Për të ruajtur interesat e pjesëmarrësve, Shoqëria Administruese ka parashikuar mjetet e mëposhtme të menaxhimit të likuiditetit, shtesë ndaj ndarjes së aktiveve të përshkruar në Kapitullin II, Seksioni 8 d) dhe pezullimit të përshkrimit në Kapitullin II, Seksioni 11: **kufizimi i tërheqjeve** dhe **zgjatja e periudhës së shlyerjes**. Aplikimi i njëkohshëm i mjeteve të përzgjedhura është i lejuar kur është i nevojshëm për të mbrojtur interesat e pjesëmarrësve.

Kufizimi i tërheqjeve Shoqëria Administruese mund të kufizojë përkohësisht tërheqjet, duke marrë parasysh gjendjen e tregut dhe rrjedhat e pritshme të pagesave. Ky kufizim përfshin të gjitha urdhrat e tërheqjes që nuk janë ekzekutuar në momentin e aktivizimit. Gjatë periudhës së kufizimit, urdhrat e tërheqjes të prekura do të ekzekutohen në mënyrë proporcionale sipas normës së ekzekutimit të përcaktuar; pjesa e urdhrit që nuk ekzekutohet skadon dhe, nëse dëshirohet, pjesëmarrësi duhet të vendosë një urdhër të ri.

Zgjatja e periudhës së shlyerjes Shoqëria Administruese mund të zgjasë përkohësisht periudhën midis afatit të vendosjes së urdhrit dhe datës së ekzekutimit të shlyerjes (periudha e shlyerjes). Zgjatja nuk ndryshon frekuencën e mundshme të kërkesave për tërheqje, por ndikon kohën e ekzekutimit të urdhrave. Kjo masë përfshin urdhrat e tërheqjes të pranuara por të paekzekutuara në momentin e aktivizimit; pas deaktivizimit, urdhrat e hapura do të ekzekutohen sipas dispozitave të Nenit 4 të Rregulloreve të Fondit dhe sipas procedurave të përshkruara në Kapitullin II, Seksioni 11 të prospektit. Çmimi i shlyerjes do të bazohet në vlerën e njësisë në datën e zbatimit të shlyerjes pas përfundimit të periudhës (përfshirë rastet e zgjatura).

Komunikimi i aktivizimit dhe deaktivizimit Çdo vendim për aktivizim ose deaktivizim të mjeteve të menaxhimit të likuiditetit do të publikohet pa vonesë në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese dhe, kur e kërkojnë rregullat e aplikueshme, do t'u komunikohet pjesëmarrësve në mënyrën e përcaktuar në prospekt.

Përdorimi i mjeteve dhe parimet e përgjithshme Mjetet e mësipërme do të përdoren vetëm kur Shoqëria Administruese vlerëson se ato janë të nevojshme për të mbrojtur interesat e pjesëmarrësve dhe për të ruajtur funksionimin e drejtë dhe të qëndrueshëm të fondit. Zbatimi do të bëhet në përputhje me parimin e trajtimit të barabartë të pjesëmarrësve dhe me dispozitat e Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe aktet nënligjore përkatëse.

2.4.4 Risqe specifike

Njoftim për investitorët, monedhat vendase të të cilëve ndryshojnë nga monedha e fondit (EUR): kthimi mund të rritet ose të bjerë për shkak të luhatjeve të monedhës.

Risqet e mëposhtme janë të aplikueshme në veçanti për Fondin Kryesor:

- Risku i tregut
- Risku i çmimit të aksioneve
- Risku i luhatjes së normës së interesit
- Risku i normave të ulëta ose negative

- Risku i kredisë
- Risku i emetuesit
- Risku i palës tjetër
- Risku i likuiditetit
- Kursi i këmbimit ose risku i monedhës
- Risku i kujdestarisë
- Risku i performancës
- Risku i inflacionit
- Risku i kapitalit
- Risku i ndryshimit të kushteve të tjera (legjislacioni tatimor)
- Risku i vlerësimit
- Risku i shtetit ose risku i transferimit
- Risku i pezullimit të shlyerjve
- Risku operacional
- Risku në rast të instrumenteve derivative
- Risku i huadhënies së titujve
- Risku për asetet e vëna si kolateral (risku i kolateralit)
- Risqet që lidhen me obligacionet e varura (subordinated bonds)
- Rreziku nga përdorimi i mjeteve të menaxhimit të likuiditetit, përfshirë pezullimin e tërheqjeve dhe segregimin e aktiveve të fondit

Këto risqe janë veçanërisht të rëndësishme për fondin. Megjithatë, duhet të theksojmë se risqet e tjera të përgjithshme të përshkruara më poshtë mund të janë gjithashtu të aplikueshme.

Rreziku nga përdorimi i mjeteve të menaxhimit të likuiditetit, përfshirë pezullimin e tërheqjeve dhe segregimin e aktiveve të fondit

Në parim, pjesëmarrësit kanë të drejtë të kërkojnë tërheqjen e njësive sipas kushteve të prospektit dhe rregulloreve të fondit. Megjithatë, Shoqëria Administruese mund të pezullojë përkohësisht ose të përdorë mjete të tjera të menaxhimit të likuiditetit në kushte të jashtëzakonshme të tregut. Në raste të tilla, vlera e kuotave mund të jetë më e ulët se para aktivizimit të masave.
Në rast segregimi të aktiveve, ekziston rreziku që asetet e segreguara të bëhen të vështira për tu likuiduar brenda një kohe të arsyeshme; si pasojë, pagesat e likuidimit mund të vonohen ose të mos jenë të plota për një periudhë të gjatë.

Përdorimi i mjeteve të menaxhimit të likuiditetit sipas Kapitulla II, Seksioni 10a përfshin, ndër të tjera, rreziqet e mëposhtme:

Kufizimi i tërheqjeve: rreziku i ekzekutimit vetëm të një pjese të urdhrave të tërheqjes.

Zgjatja e periudhës së shlyerjes: rreziku që shlyerjet të ekzekutohen më vonë dhe me çmimin e shlyerjes të vlefshëm në atë moment.

Tarifat e shlyerjes: në rast se aplikohet tarifë për tërheqje, ekziston rreziku i reduktimit të shumës neto që i paguhet pjesëmarrësit.

2.4.5 Risqe të përgjithshme & Përkufizime

Risku i Tregut
Risku që i gjithë tregu për një klasë asetesh të performojë negativisht dhe kjo të ndikojë negativisht në çmimin dhe vlerën e këtyre investimeve. Ecuria e instrumentave është veçanërisht e varur nga zhvillimi i tregjeve të kapitalit. Nga ana e tyre, këto të fundit ndikohen nga situata e përgjithshme e ekonomisë botërore dhe nga kushtet ekonomike e politike në vendet përkatëse.

Risku i çmimit të aksioneve
Risku i çmimit të aksioneve është një formë e caktuar e riskut të tregut. Kjo lidhet me mundësinë që aksionet apo tituj me tipare të ngjashme me aksionet të përjetojnë luhatje të ndjeshme të çmimeve. Në veçanti, çmimi aktual i një aksioni apo një titulli me tipare të ngjashme mund të bjerë kështu nën çmimin me të cilin është blerë. Si çmim tregu, ky çmim pasqyron raportin e ofertës dhe kërkesës në kohën e vlerësimit. Pritshmëritë ekonomike në lidhje me kompanitë dhe industritë si dhe mjedisin e përgjithshëm ekonomik, pritshmëritë politike, spekullimet dhe blerjet spekulative janë faktorë të rëndësishëm që formojnë pritshmërinë e çmimeve.

Risku i luhatjes së normës së interesit
Ky risk i referohet mundësisë së një ndryshimi në normën e interesit të tregut mbizotëruese në momentin e emetimit të një titulli me të ardhura fikse ose një instrumenti të tregut të parasë. Në qoftë se normat e interesit të tregut rriten, atëhere çmimet e titujve me të ardhura fikse apo instrumenteve të tregut të parasë përgjithësisht do të bien. Nga ana tjetër, në qoftë se normat e interesit të tregut bien, kjo do të ketë një efekt të kundërt në titujt me të ardhura fikse apo instrumentet e tregut të parasë. Titujt me të ardhura fikse me maturime më të shkurtra janë subjekt i risqeve më të ulta të çmimeve sesa titujt e tillë me maturime më të gjata.

Risku i normave të ulëta ose negative
Normat e interesit të ulëta apo edhe negative të obligacioneve dhe instrumenteve të tregut të parasë mund të ndikojnë negativisht në vlerën neto të aseteve të fondit dhe mund të mos jenë të mjaftueshme për të mbuluar tarifat e vazhdueshme.

Risku i kredisë/risku i emetuesit
Risku që një emetues apo palë tjetër nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e tij. Përveç karakteristikave të përgjithshme të tregjeve të kapitalit, çmimi i një titulli ndikohet gjithashtu nga sjellja individuale e emetuesit përkatës. Edhe kur titujt përzgjidhen me kujdesin më të madh nuk është e mundur të përjashtohen, për shembull, humbjet për shkak të humbjeve financiare ose paaftësisë paguese të emetuesve.

Risku i palës tjetër
Risku që një shlyerje në një sistem klerimi të mos përmbushet pasi pala tjetër nuk paguan ose dorëzon siç pritej ose e bën këtë me vonesë.

Risku i likuiditetit
Është risku që një pozicion nuk mund të likuidohet në kohë të përshtatshme me një çmim të përshtatshëm. Duke marrë në konsideratë përfitimin dhe risqet e lidhura me investimin në aksione dhe obligacione, shoqëria administruese e Fondit Kryesor do të investojë kryesisht në tituj që janë të listuar zyrtarisht në bursat në Austri ose jashtë vendit ose që tregtohen në tregje të organizuara që janë tregje të njohura, të aksesueshme nga publiku dhe që funksionojnë siç duhet.

Pavarësisht nga kjo, tregtimi i titujve të caktuar, në faza të caktuara ose në segmente të caktuara të bursës mund të jetë problematik në momentin e dëshiruar. Ekziston gjithashtu risku që titujt e tregtuar në një segment tregu të ngushtë mund të shfaqin paqëndrueshmëri të konsiderueshme të çmimeve.

Përveç kësaj, shoqëria administruese mund të blejë emetime fillestare të titujve, kushtet dhe termat e emetimit të të cilave përfshijnë një detyrim për të aplikuar për një listim zyrtar në një bursë ose treg të organizuar jo më vonë se një vit që nga dita e tyre e emetimit.

Risku i kursit të këmbimit ose i monedhës
Risku i monedhës, i referuar gjithashtu si risku i kursit të këmbimit, është mundësia që zhvlerësimi i monedhës të ndikojë negativisht në vlerën e aseteve, investimeve dhe pagesat e lidhura me interesat ose dividentët, veçanërisht per titujt e emetuar në një monedhë të ndryshme nga monedha e fondit.

Risku i grumbullimit/përqendrimit
Risqe të mëtejshme mund të vijnë nga përqendrimi i investimit në disa asete ose tregje.

Risku i performancës
Performanca e aseteve të blera për fondin e investimit mund të devijojë nga parashikimet e bëra në kohën e blerjes. Kështu që nuk është e mundur të përjashtohen humbjet nga luhatja e çmimeve.

Risku në rast të instrumenteve derivative
Si pjesë e manaxhimit të rregullt të një fondi investimi, subjekt i disa kushteve dhe kufizimeve, shoqëria administruese e Fondit Kryesor mund të blejë instrumente financiare derivative brenda kuptimit të Aktit Austriak të Fondit të Investimeve.

Duhet theksuar se derivativet mund të sjellin risqe, të tilla si:
a. Të drejtat me afat të kufizuar mund të skadojnë ose të pësojnë një humbje të vlerës.
b. Risku i humbjes mund të mos jetë i llogaritshëm dhe mund të tejkalojë çdo kolateral të dhënë.
c. Transaksionet e projektuara për të përjashtuar ose zvogëluar risqet mund të mos jenë të mundshme ose mund të jenë të mundshme vetëm me çmim tregu duke shkaktuar kështu humbje.
d. Risku i humbjes mund të rritet nëse detyrimet e lidhura me transaksione të tilla ose të drejtat që mund të pretendohen si rezultat i transaksioneve të tilla janë përcaktuar në një monedhë të huaj.

Risqet që lidhen me obligacionet e varura
Obligacionet e varura (subordinated) – në veçanti, obligacionet hibride dhe obligacionet me karakteristika thelbësore të kapitalit të cilat lëshohen nga institucionet e kreditit ose nga ofrues të tjerë të shërbimeve financiare – mund të kenë një profil risku të ngjashëm me aksionet në rrethana të caktuara. Ato janë të ekspozuara ndaj një risku në rritje që emetuesi të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij të pagesës së interesit apo të shlyerjes së detyrimit ose të jetë në gjendje ta bëjë këtë vetëm pjesërisht ose me vonesë.

Risku i falimentimit të garantuesit
Risku i investimit rritet ose bie në varësi të aftësisë paguese së çdo garantuesi. Për shembull, një falimentim i garantuesit mund të nënkuptojë se garancia nuk është më e zbatueshme ose të paktën nuk është më e zbatueshme plotësisht.

Risku i inflacionit
Kthimi nga investimi mund të ndikohet negativisht nga pritshmëria e inflacionit. Mjetet monetare të investuara mund të jenë nga njëra anë subjekt i një rënieje në fuqinë blerëse për shkak të një rënieje në vlerën e parasë, nga ana tjetër prirja e inflacionit mund të ketë një efekt të drejtpërdrejtë (negativ) në performancën e aseteve.

Risku i kapitalit
Risku i kapitalit të fondit të investimeve aplikohet në veçanti nëse asetet shiten më lirë sesa janë blerë. Kjo përshin gjithashtu riskun e shterimit për riblerjet dhe shpërndarjet e tepruara të kthimeve nga investimi.

Risku i vlerësimit
Veçanërisht në kohërat e mungesave të likuiditetit të përjetuara nga pjesëmarrësit në treg për shkak të krizave financiare dhe një humbjeje të përgjithshme besimi, përcaktimi i çmimeve për disa tituj dhe instrumente të tjera financiare në tregjet e kapitalit mund të kufizohet, duke penguar vlerësimet e fondit. Kur investitorët në të njëjtën kohë shlyejnë sasi të mëdha kuotash, për të ruajtur likuiditetin e përgjithshëm të fondit, manaxheret e fondit mund të detyrohen të shesin tituj me çmime që devijojnë nga çmimet aktuale të vlerësimit.

Risku i ndryshimit të kushteve të tjera, përshirë legjislacionin e taksimit
Vlera e aseteve të fondit të investimeve mund të ndikohet negativisht për shkak të pasigurive në vendet në të cilat bëhen investimet, p.sh. trendet e politikës ndërkombëtare, ndryshime në politikën e qeverisë, taksimi, kufizimet mbi investimet e huaja, luhatjet e monedhës dhe prirje të tjera në drejtim të legjislacionit dhe kuadrit rregullativ. Fondi gjithashtu mund të tregtojë në bursa të cilat nuk janë aq mirë të rregulluara sa ato në SHBA dhe vendet e BE-së.

Risku i shtetit ose risku i transferimit
Risku i shtetit i referohet një situate ku një debitor i huaj nuk është në gjendje, pavarësisht nga aftësia e tij paguese, të bëjë pagesa ose të bëjë pagesa në kohën e duhur, për shkak të paaftësisë apo mungesës së gatishmërisë nga ana e vendit të tij të rezidencës për të bërë transferime.

Risqet në lidhje me kuotat e fondeve të tjera (fondet e synuara)
Risqet për fondet të cilat synohen të blihen për Fondin Kryesor janë të lidhura ngushtë me risqet e aseteve të përfshira në këto fonde dhe strategjitë e tyre të investimit.
Meqënëse administratorët e fondeve individuale të synuara mund të veprojnë në mënyrë të pavarur nga njëri-tjetri, është e mundur që fondet e shumta të synuara mund të ndjekin të njëjtat strategji ose strategji të kundërta investimi. Kjo mund të shkaktojë një mbivendosje të risqeve ekzistuese apo dhe anullim të përfitimeve.

Risku i huadhënies së titujve
Në rastet e huadhënies së titujve nga ana e Fondit Kryesor, mund të ndodhë qe titujt të kthehen me vonesë ose të mos kthehen fare. Për shkak të humbjeve financiare të pësuara nga huamarrësi i titujve në veçanti, ky i fundit mund të mos jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij ndaj fondit të investimit (risku i falimentimit).

Risku për asetet e vëna si kolateral (risku i kolateralit)
Nëse palët e treta sigurojnë kolateral për Fondin Kryesor, fondi do t'u nënshtrohet risqeve tipike të investimit që lidhen me atë kolateral, duke përfshirë riskun që një pozicion nuk mund të likuidohet në kohë të përshatshme dhe me një çmim të përshtatshëm (risku i likuiditetit) dhe riskut që lidhet me kujdestarinë e kolateralit (riskut të kujdestarisë) dhe riskut operacional që lidhet me administrimin e kolateralit, p.sh. në rast të një gabimi në perllogaritjen e kolateralit të kërkuar.

Risku i mallrave
Si titujt e lidhur me mallrat, - në veçanti, aksionet apo obligacionet e emetuara nga kompanitë që operojnë në sektorin e mallrave -, ashtu edhe obligacionet e strukturuara të cilat janë kolateralizuar me anë të mallrave dhe derivateve të mallrave ose që janë të lidhura me ecurinë e çmimeve të tyre dhe instrumentet derivative të cilat janë të lidhura me ecurinë e indekseve të mallrave ose fondeve të mallrave, ose fondeve të investimit me aksione mallrash (indeksi) në të cilat Fondi Kryesor investon në formën e nën-fondeve, janë të ekspozuara, në veçanti, ndaj risqeve të mëposhtme që janë tipike për tregjet e mallrave dhe tregjet e kontratave të së ardhmes së mallrave dhe që mund të ndikojnë negativisht në vlerën e kuotave: luhatjet e forta në ofertë dhe/ose kërkesë, ndërhyrja e qeverisë, kushtet e pafavorshme të motit, katastrofat mjedisore, mosmarrëveshjet politike (globale), lufta dhe terrorizmi.

Risqet e lidhura me titujt e mbështetur në asete (ABS)/titujt e mbështetur me hipotekë (MBS)/detyrimet e kolateralizuara të borxhit (CDO)
Investimet në ABS, MBS dhe CDOs (në vazhdim: "ABS") bazohen në transferimin të pozicioneve të aseteve në një "mjet qëllimi të posaçëm" (SPV). Emetimi i ABS është normalisht "i strukturuar", d.m.th. grupi i aseteve siguron bazën për transhe të ndryshme të ABS, pretendimet e të cilave do të shlyhen sipas përparësisë së transhit përkatës, në rast të falimentimit të grupit të aseteve, ku transhet e borxhit të varur do të shërbejnë si një rezervë për humbjet e transheve më prioritet më të lartë. Përveç pagesave të principalit ose falimenteve, me këtë lloj strukture të ABS grupi i aseteve mund të ekspozohet edhe ndaj ndryshimeve për shkak të transaksioneve të ndërmarra nga njësia ose njësitë që manaxhojnë grupin e aseteve. Përveç kësaj, tipare që pakësojnë nivelin e riskut mund të përfshijnë garancitë e palëve të treta ose sigurimin e kredisë.

Për shkak të shumëllojshmërisë dhe kompleksitetit të ABS, në raste të veçanta, këto mund të jenë të ekspozuara ndaj risqeve shumë specifike dhe kështu janë të papajtueshme me një profil universal risku.

Risku operacional
Risku operacional nënkupton risqet që lindin nga proceset e brendshme të pamjaftueshme si dhe gabimeve njerëzore ose të sistemit në shoqërinë administruese ose për shkak të ngjarjeve të jashtme të tilla si efektet negative në instrumentet financiare nga ndryshimet ose ndërprerje e kuotimit të një norme reference ose norme interesi ndërbankare. Ky risk përfshin risqe ligjore, kontraktuale dhe të dokumentimit dhe risqe që rezultojnë nga procedurat e tregtimit, shlyerjes dhe vlerësimit të fondit.

Risku i personelit kyç
Performanca e një fondi që realizon një kthim shumë të favorshëm investimi brenda një periudhe të caktuar i atribuohet pjesërisht aftësisë së personave përgjegjës dhe vendimeve të sakta të marra nga drejtuesit e fondit. Megjithatë, përbërja e personelit të manaxhimit të fondit mund të ndryshojë. Vendim-marrësit e rinj mund të jenë më pak të suksesshëm në veprimtaritë e tyre.

Risku i pezullimit të shlyerjeve
Në parim, mbajtësit e kuotave mund të kërkojnë shlyerjen e kuotave të tyre në çdo kohë. Megjithatë, shoqëria administruese e Fondit Kryesor mund të pezullojë përkohësisht shlyerjen e kuotave në rast të rrethanave të jashtëzakonshme. Çmimi i kuotave mund të jetë më i ulët se çmimi përpara pezullimit të shlyerjeve.

Risku i kujdestarisë
Risku i kujdestarisë është risku i humbjes së aktiveve të mbajtura në një llogari depozite për shkak të falimentimit, neglizhencës ose sjelljes mashtruese nga banka kujdestare/depozitari ose banka nën kujdestare/nën-depozitari.

Kujdestaria e aseteve të Fondit Kryesor është subjekt i një risku humbjeje për shkak të paaftësisë paguese, shkeljes së një detyre të kujdestarisë ose sjelljes abuzive nga kujdestari ose një nën-kujdestar.

2.5 Marrja e dokumentacionit të rëndësishëm të fondit kryesor

Investitorët mund të pajisen me dokumentacionin e Fondit Kryesor, siç janë Prospekti i fondit, Dokumenti i Informacionit Kryesor për Investitorin (KIID), rregulloret e fondit, raporti vjetor i fondit dhe raporti gjashtëmujor i fondit, pa pagesë, në faqen e internetit: www.rcm.at në gjuhën Gjermane, dhe në faqen e internetit: www.rcm-international.com në gjuhën Angleze. Gjithashtu, investitorët mund t'i gjejnë këto dokumente në gjuhën angleze në faqen zyrtare të Raiffeisen Invest: www.raiffeisen-invest.al

2.6 Tarifat e fondit kryesor

Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H e ka të ndaluar t'i ngarkojë Fondit Furnizues tarifë hyrjeje dhe tarifë daljeje; përveç tarifave të vazhdueshme të Fondit Kryesor, asnjë tarifë apo shpenzim tjetër nuk do të paguhet nga Fondi Furnizues.

Tarifat e vazhdueshme nuk përfshijnë kostot e transaksioneve dhe mund të ndryshojnë nga viti në vit.

Në përputhje me marrëveshjen e lidhur midis dy shoqërive administruese të fondeve, Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H do të kryeje pagesën e një rabati drejt Fondit Furnizues, me qëllim kthimin e një pjese të të ardhurave nga tarifa e administrimit, e përfituar për administrimin e Fondit Kryesor.

2.7 Pasojat fiskale të investimeve në kuotat e fondit kryesor

Fondi Furnizues nuk është një tatimpagues sipas Ligjit Austriak të tatimit mbi të ardhurat.

Investimi i Fondit Furnizues në kuota të Fondit Kryesor nuk ka një ndikim fiskal në rritjen e kostove të Fondit Furnizues.

2.8 Përmbledhje e marrëveshjes së lidhur midis dy shoqërive administruese të fondeve

Shoqëria administruese e Fondit Furnizues (Raiffeisen Invest sh.a) dhe shoqëria administruese e Fondit Kryesor (Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft mbH) kanë lidhur një marrëveshje që rregullon të drejtat dhe detyrimet e tyre të ndërsjellta në lidhje me shkëmbimin e informacionit dhe detyrime të tjera që lindin në lidhje me investimin ose shitjen e kuotave nga ana e Fondit Furnizues, si dhe me parimet standarde të tregtimit. Më konkretisht, marrëveshja përfshin mënyrën dhe afatet e shkëmbimit të ndërsjellë të informacionit, dispozitat që rregullojnë procesin e koordinimit të përllogaritjes së vlerës neto të aktiveve të Fondit Kryesor dhe Fondit Furnizues dhe njoftimit të këtyre vlerave, dispozitat që rregullojnë koordinimin e depozitimit dhe përpunimit të kërkesave të shoqërisë administruese të Fondit furnizues për blerje ose shitje kuotash, si dhe trajtimin e duhur të kërkesave dhe ankesave të mbajtësve të kuotave.

3 Informacion i përgjithshëm mbi fondin furnizues

3.1 Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid

Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid (në vijim Fondi Furnizues) është krijuar nga Raiffeisen Invest sh.a. si një Fond Furnizues i Fondit Kryesor të administruar nga Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H.

Fondi Furnizues është një sipërmarrje e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike në tituj të transferueshem.

Fondi Furnizues nuk mbështetet apo garantohet në asnjë formë nga Raiffeisen Bank sh.a. ose Raiffeisen Invest sh.a., ai nuk është një produkt bankar dhe risku i investimit i përket tërësisht investitorit.

Investimi në Fondin Furnizues nuk është një depozitë bankare dhe si i tillë nuk është i siguruar nga Agjencia Shqiptare e Sigurimit të Depozitave.

3.1.1 Mjetet e menaxhimit të likuiditetit

Për qëllimin e mbrojtjes së interesave të pjesëmarrësve
Shoqëria Administruese ka përcaktuar si mjete të menaxhimit të likuiditetit: kufizimin e tërheqjeve dhe zgjatjen e periudhës së shlyerjes. Aplikimi i njëkohshëm i një ose më shumë mjeteve të përzgjedhura është i lejuar kur është i nevojshëm për të ruajtur interesat e pjesëmarrësve dhe për të siguruar funksionimin e qëndrueshëm të fondit.

Kufizimi i tërheqjeve
Shoqëria Administruese mund të kufizojë përkohësisht tërheqjet duke marrë parasysh mjedisin e tregut dhe rrjedhat e pritshme të pagesave. Gjatë periudhës së kufizimit, urdhrat e tërheqjes do të trajtohen në mënyrë proporcionale sipas normës së ekzekutimit të përcaktuar; pjesa e urdhrit që nuk ekzekutohet skadon.

Zgjatja e periudhës së shlyerjes
Shoqëria Administruese mund të zgjasë përkohësisht periudhën midis afatit të vendosjes së urdhrit dhe datës së ekzekutimit të shlyerjes. Zgjatja nuk ndryshon frekuencën e mundshme të kërkesave për tërheqje, por ndikon kohën e ekzekutimit të urdhrave.

Zbatimi dhe komunikimi
Modalitetet e detajuara të zbatimit, përfshirë kriteret e aktivizimit, mënyrën e llogaritjes së normës së ekzekutimit dhe procedurat e komunikimit me pjesëmarrësit, do të përcaktohen në rregulloret e brendshme të Shoqërisë Administruese dhe në dispozitat përkatëse të Rregulloreve të Fondit. Çdo aktivizim ose deaktivizim do të publikohet pa vonesë në faqen zyrtare të Shoqërisë Administruese dhe do të njoftohet sipas kërkesave ligjore dhe rregullatore.

Përputhshmëria me legjislacionin
Zbatimi i këtyre mjeteve do të bëhet në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", aktet nënligjore dhe udhëzimet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

3.2 Data e krijimit të fondit, kohëzgjatja dhe monedha

Fondi Furnizues është krijuar më datë 28.03.2024 me miratimin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, me vendim numër 47, me Licencë nr.14.

Fondi u krijua si një Fond Furnizues, për një periudhë të pacaktuar dhe ka filluar veprimtarinë e tij më 07.05.2024

Monedha e Fondit Furnizues është Euro. Investimet dhe shlyerjet bëhen në Euro.

3.2.1 Të dhëna historike

Në datë 31 Dhjetor 2025, kthimi kumulativ i fondit që nga lançimi është 3.75%.
Në datë 31 Dhjetor 2025, kthimi vjetor neto i fondit pasi është zbritur tarifa e vazhdueshme vjetore është -0.37%.

Tarifa e vazhdueshme zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi. Tarifa e vazhdueshme që mbështetet në shpenzimet për vitin e mbyllur më 31.12.2025 është 1.58%.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë nje premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen.
Performanca e shkuar është e llogaritur në monedhën Euro.

3.3 Qëllimi i investimit dhe politika e investimit

Shënim: Fondi Furnizues synon të jetë në përputhje me qëllimet e tij të investimit. Sidoqoftë, nuk mund të ketë asnjë siguri që këto qëllime investimi do të përmbushen. Shoqëria e Administrimit nuk garanton një performancë specifike për Fondin Furnizues. Përshkrimi i mëposhtëm nuk pasqyron profilin individual të riskut të një investitori të mundshëm. Ne rekomandojmë që investitorët të marrin këshilla investimi nga ekspertë, të cilët mund të vlerësojnë nëse Fondi Furnizues është i përshtatshëm për rrethanat e tyre personale.

3.3.1 Qëllimi i investimit

Qëllimi i investimit të Fondit Furnizues është t'u mundësojë investitorëve të përfitojnë nga kthimi i Fondit Kryesor. Qëllimi i investimit të Fondit Furnizues është krijimi i të ardhurave të rregullta në një periudhë afatmesme.

3.3.2 Politika e investimit

Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, Fondi Furnizues në çdo kohë investon të paktën 85% të aseteve të tij në kuota të Fondit Kryesor.

Për qëllime të manaxhimit të likuiditetit, Fondi Furnizues mund të investojë deri në 15% të aseteve të tij në: depozita bankare, transaksione të marrëveshjes së Riblerjes / të anasjelltë të riblerjes, cash apo ekuivalentë të tij.

Fondi Furnizues synon të investojë më shumë se 85% të aseteve të tij në Fondin Kryesor dhe niveli i likuiditetit synohet të jetë 2% i totalit të aseteve.

Instrumentet kryesore të politikës së investimit të Fondit Furnizues janë:

- Kuota të Fondit Kryesor
- Instrumente të tregut të parasë: Depozita bankare & transaksione të marrëveshjes së Riblerjes / të anasjelltë të riblerjes me institucione financiare, të regjistruara në Republikën e Shqipërisë ose në një vend të BE-së ose të lejuar nga AMF, me maturim deri në një vit, Cash apo ekuivalentë të tij në bankën depozitare të Fondit Furnizues.

Shoqëria Administruese angazhohet të respektojë të gjitha kufizimet e investimeve të parashikuara nga Ligji nr. 56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" dhe nga politika e investimit dhe politika e manaxhimit të riskut të Fondit Furnizues për çdo instrument të përmendur më sipër.

Strategjia e investimit të Fondit Furnizues do të jetë pasive. Duke pasur parasysh faktin se të paktën 85% e aseteve të Fondit Furnizues do të investohen në kuota të Fondit Kryesor, performanca e Fondit Furnizues do të varet ndjeshëm nga performanca e Fondit Kryesor. Performanca e Fondit Furnizues do të ndikohet nga niveli i mbajtur i cash-it dhe mjeteve monetare likuide. Struktura e tarifave do të ndikojë në performancën e Fondit Furnizues.

3.3.3 Profili i investorit

Fondi Furnizues është i përshtatshëm për ata investitorë që kuptojnë natyrën e fondit si një fond Furnizues dhe janë të përgatitur të marrin përsipër një shkallë mesatare risku duke u ekspozuar si ndaj tregut të obligacioneve ashtu edhe ndaj tregut të aksioneve.

Fondi Furnizues i drejtohet investitorëve që duan të mbështesin investimet e qëndrueshme dhe synojnë të ndikojnë në mënyrë të qëndrueshme në mjedis, shoqëri dhe ekonomi përmes investimit të tyre. Këta investitorë kërkojnë të marrin pjesë në tregjet globale të obligacioneve dhe të aksioneve përmes një investimi të qëndrueshëm.

Investitorët e Fondit Furnizues duhet të kenë eksperiencën dhe njohuritë e duhura për produktet e investimit dhe tregjet e kapitalit ose duhet të konsultohen në mënyrë që të jenë në gjendje të vlerësojnë risqet dhe avantazhet që lidhen me investimin në Fondin Furnizues.

Horizonti kohor minimal i investimit i rekomanduar për arritjen e objektivave të performancës është të paktën 5 vjet.

Fondi Furnizues është i përshtatshëm për kursime të rregullta periodike (plan investimi) si dhe për një investim të vetëm.

3.4 Profili i riskut i fondit furnizues

Çdo fond furnizues do t'i nënshtrohet risqeve të veta specifike, si dhe risqeve specifike të lindura në nivel të Fondit Kryesor dhe investimeve të tij. Nëse Fondi Kryesor investon në një kategori të caktuar asetesh, treg financiar apo sektor ekonomik, apo ndjek një strategji të caktuar investimi atëherë Fondi Furnizues do të jetë i ndikueshëm nga performanca e asaj kategorie të caktuar aseti, tregu financiar, sektori ekonomik apo strategjie investimi.

Prandaj, përpara se të investojnë, investitorët potencialë duhet të lexojnë me kujdes përshkrimin e faktorëve të riskut të lidhur me investimin në Fondin Kryesor, siç paraqitet në Seksionin 2.4 të këtij Prospekti ose në prospektin e Fondit Kryesor që mund të gjendet pa pagesë në faqen e internetit: www.rcm.at në gjuhën gjermane, gjithashtu në faqen e internetit www.rcm-international.com në gjuhën angleze (ju lutemi referojuni seksionit 2.5).

Përveç faktorëve të riskut të sipërpërmendur, investitorët e mundshëm të Fondit Furnizues duhet të marrin në konsideratë risqet e mëposhtme që lidhen me Fondin Furnizues dhe Shoqërinë Administruese.

3.4.1 Risqe që lidhen me investimin

Risku i Likuiditetit dhe i Vlerësimit
Kur një fond është fond furnizues, synohet që Fondi Furnizues të investojë në thelb të gjitha asetet e tij në Fondin Kryesor, me përjashtim të një shume të mbetur mjetesh monetare që mund të nevojitet herë pas here për qëllime të likuiditetit dhe për pagesën e kostove dhe shpenzimeve të Fondit Furnizues.

Vlera Neto e Aseteve të Fondit Furnizues do të varet kryesisht nga Vlera Neto e Aseteve të Fondit Kryesor.

Rrjedhimisht, Vlera Neto e Aseteve për Kuotë mund të përcaktohet vetëm pasi të jetë përcaktuar Vlera Neto e Aseteve të Fondit Kryesor. Vlera e kuotave që do të blihen, transferohen ose shlyhen nga një investitor në Fondin Furnizues mund të mos jetë e mundur të përcaktohet derisa të përcaktohet Vlera Neto e Aseteve për Kuotë të Fondit Kryesor. Përcaktimi i Vlerës Neto të Aseteve për Kuotë mund të jetë subjekt pezullimi si rrjedhojë e një pezullimi të llogaritjes së Vlerës Neto të Aseteve për Kuotë të Fondit Kryesor ose çdo pezullim ose shtyrje tjetër të shitjes, shlyerjes dhe/ose transferimit të kuotave në Fondin Kryesor.

Gjithashtu në rast të aktivizimit nga fondi kryesor të kufizimit të tërheqjeve, segregimit të fondit dhe pezullimit ose zgjatjes së periudhës së shlyerjes, likuditeti i fondit furnizues mund të impaktohet dhe fondi furnizues do duhet të aktivizojë të njejtat mjete të menaxhimit të likuiditetit si fondi kryesor.

Risku i Përqendrimit dhe Risku i tregut
Duke pasur parasysh natyrën furnizuese të Fondit, ai natyrshëm do të jetë i përqendruar në Fondin Kryesor. Prandaj, risqet e përqendrimit dhe risqet e tregut janë kryesisht të lidhura me Fondin Kryesor. Si rrjedhojë, investitorët duhet të lexojnë me kujdes risqet që lidhen me investimin në Fondin Kryesor, siç përshkruhet në Seksionin 2.4 të këtij Prospekti ose në Prospektin e Fondit Kryesor.

Risku i manaxhimit të investimit
Risku i Manaxhimit të Investimit është risku që strategjia e investimit e zbatuar nga Fondi Kryesor të mos sjellë rezultatet e pritura.

Risku i palës tjetër
Risku që pagesa në një sistem transfertash të mos kryhet ose të kryhet me vonesë. Gjithashtu ky risk lidhet me mundësinë që pala tjetër të mos jetë në gjendje të realizojë pagesat sipas kushteve të një marrëveshjeje apo transaksioni të paracaktuar.

3.4.2 Risqe që lidhen me shoqërinë administruese

Risqe operacionale dhe ligjore
Risku operacional mund të shkaktohet nga gabime njerëzore ose të sistemeve brenda shoqërisë administruese, nga ekzistenca e proceseve të brendshme të papërshtatshme, nga gabime ligjore ose të dokumentacionit, si dhe nga procedurat e marketingut, të vlerësimit dhe pagesave në emër të fondit.

Risku Ligjor është risku i humbjeve që lindin për shkak të çështjeve ligjore të shkaktuara nga paaftësia e Shoqërisë Administruese për të zbatuar kontratat ligjore, licencat dhe/ose të drejtat e pronësisë.

Risku Reputacional
Risku reputacional nënkupton riskun e dëmtimit të besueshmërisë së Shoqërisë Administruese në tregun ku vepron. Ky risk përmbledh impaktin e ngjarjeve specifike të cilat mund të përkeqësojnë apo ndikojnë negativisht mbi perceptimin e publikut për shoqërinë.

Risku i Personelit dhe personave kyç
Veprimtaria e Shoqërisë Administruese varet nga personat përgjegjës dhe si rrjedhim nga vendimet e sakta të marra nga Këshilli i Administrimit, Komiteti i Investimeve ose drejtuesit e fondit. Megjithatë, përbërja e personelit mund të ndryshojë dhe vendimmarrësit e rinj mund të jenë më pak të suksesshëm në aktivitetet e tyre.

Risku nga delegimi i funksioneve
Disa funksione, si për shembull shitja e fondit, i delegohen palëve të treta dhe mund të gjenerojnë risk sepse Shoqëria Administruese mban përgjegjësinë finale ligjore për funksionet e deleguara.

3.4.3 Risqet që ndikojnë te investitorët dhe shoqëria administruese

Risku i pezullimit të shlyerjes së kuotave
Në parim, investitori mund të kërkojë në çdo moment shlyerje të kuotave të Fondit. Megjithatë, shoqëria administruese apo AMF mund të pezullojë përkohësisht shlyerjen e kuotave, në rastet e parashikuara sipas ligjit. Vlera e kuotës mund të jetë më e ulët se para pezullimit të shlyerjeve.

Risku Regullator
Risku rregullator lidhet me mundësinë e ndryshimeve të kuadrit rregullator, përfshirë legjislacionin tatimor.

Risku i Depozitarit
Funksioni i depozitarit duhet të mbulohet nga një shoqëri e licencuar dhe e mbikqyrur nga AMF. Në rast se, për një arsye apo një tjetër, kjo shoqëri nuk mund të përmbushë detyrimet e saj ligjore, disa aktivitete të fondit, si për shembull përllogaritja e vlerës neto të aseteve apo procesit të investimit, mund të vonohen. Gjithashtu, ekziston nje risk i humbjes së aseteve të fondit për shkak të paaftësisë paguese, neglizhencës, shkeljes së një detyre të kujdestarisë ose sjelljes abuzive apo mashtuese nga kujdestari / depozitari ose një nën-kujdestar i tij.

3.5 Shuma minimale e investimit

Kuotat në Fondin Furnizues janë të emetuara në Euro. Shuma minimale e investimit në Fondin Furnizues është 500 EUR. Vlera minimale e llogarisë për qëndrimin në Fondin Furnizues është 100 EUR. Nëse balanca e llogarisë mbetet më e vogël se 100 EUR, llogaria mund të mbyllet. Në këtë rast, kuotat do të shlyhen me çmimin e aplikueshëm në ditën e mbylljes.

Çdo blerje apo shlyerje kuotash në Fondin Furnizues do të bëhet në EUR.

3.6 Të drejtat dhe detyrimet nga kuotat

Në momentin e blerjes së kuotave në Fondin Furnizues, çdo investitor mund të kërkojë lëshimin e një certifikate e cila vërteton pronësinë mbi kuotat. Certifikata lëshohet me kërkesë të investitorit, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e mbërritjes së pagesës në Fondin Furnizues. Ajo përmban: datën e blerjes së kuotave, emërtimin e fondit, emrin dhe selinë e regjistruar të shoqërisë administruese, numrin e kuotave të blera, emrin dhe mbiemrin e mbajtësit të kuotave, vendin dhe datën e lëshimit të certifikatës, si dhe nënshkrimin e personit të autorizuar të shoqërisë administruese.

Të drejtat që lidhen me pronësinë e kuotave në Fondin Furnizues janë:

- E drejta e informimit (raporte vjetore, gjashtë mujore etj);
- E drejta për të marrë pjesë në fitimet e fondit, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të;
- E drejta për të shitur kuotat në çdo kohë;
- E drejta që asetet e fondit, në rast falimenti të Shoqërisë Administruese, të jenë objekt i së drejtës së ndarjes.

Në lidhje me detyrimet që lindin nga kuotat, mbajtësit e kuotave janë përgjegjës për detyrimet e fondit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në fond.

Mbajtësi i kuotave të fondit nuk mban përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese ose depozitarit të fondit.

Shoqëria Administruese është përgjegjëse për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të kuotave të fondit. Depozitari i fondit mban njëkohësisht regjistrin e kuotave të fondit, si dhe verifikon dhe kontrollon që çdo veprim i shoqërisë administruese, në lidhje me këtë regjistër, është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 56/2020 dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

3.7 Mënyra dhe kushtet e blerjes apo shlyerjes së kuotave

Kuotat e Fondit Furnizues do të ofrohen në treg fillimisht nëpërmjet rrjetit të degëve të Raiffeisen Bank sh.a, i cili përbëhet nga një staf i trajnuar dhe autorizuar për shitje nga shoqëria administruese, dhe më pas edhe nëpërmjet platformave digjitale Raiffeisen ON dhe RaiYouth. Këto platforma përdoren gjerësisht nga klientët e Raiffeisen Bank sh.a në Shqipëri. Gjatë procesit të investimit digjital, dokumentacioni i fondit (Prospekti, Dokumenti me Informacionin Kryesor për Investitorin, raportet e fondit, etj) do të shfaqen si fusha të detyrueshme, të cilat duhet të lexohen paraprakisht nga investitori përpara marrjes së një vendimi për investim. Vetëm pasi investitori t'i ketë lexuar dhe konfirmuar se i ka kuptuar dhe ka rënë dakord me kushtet e parashikuara në to, ai do mund të vijojë me kryerjen e investimit online në fond.

Shlyerja e kuotave do të realizohet nëpërmjet degëve të Raiffeisen Bank sh.a.

Asnjë kuotë nuk mund të shitet ose të shlyhet me çmim tjetër përveç çmimit të ardhshëm të llogaritur pas marrjes së urdhrit për blerjen ose shitjen e kuotave.

3.7.1 Blerja e kuotave në fond

Blerja e kuotave në Fondin Furnizues kryhet nëpërmjet:
1. pagesës së aseteve monetare ku blerësi, pas blerjes së kuotave, hyn në një marrëdhënie ligjore me shoqërinë administruese, e cila është e detyruar të administrojë asetet e paguara si pjesë të aseteve kolektive, në përputhje me kushtet dhe kriteret e treguara në prospekt;
2. këmbimit të kuotave të fondeve të tjera të investimit në të njëjtën monedhë, të manaxhuara nga e njëjta shoqëri administruese.

Çdo pagesë për blerje kuotash kryhet në llogarinë bankare të Fondit Furnizues me nr: AL48 2151 1031 EUR1 0000 1987 3000 të hapur pranë depozitarit, i cili është Banka e Parë e Investimeve, Shqipëri, në një nga mënyrat e mëposhtme:
- Transfertë bankare drejt llogarisë së Fondit tek depozitari (kundrejt tarifave në fuqi);
- Këmbimi i kuotave midis fondeve të investimit në të njëjtën monedhë të manaxhuara nga e njëjta shoqëri administruese.

Blerja e kuotave në Fondin Furnizues mund të kryhet si më poshtë:
1. Nëpërmjet një pagese të menjëhershme në llogarinë e fondit.
2. Nëpërmjet pagesave të rregullta, periodike, në llogarinë e fondit, në formën e planeve të investimit. Në rastin e planeve të investimit, shuma minimale e investimit në Fond është 50 euro.

Çdo investitor që dëshiron të blejë kuota në Fondin Furnizues nëpërmjet pagesës së menjëhershme ose planeve të investimit , do të nënshkruajë një kërkesë për blerje kuotash (urdhër-blerja) në një nga degët e rrjetit të Raiffeisen Bank sh.a. ose përmes kanaleve digjitale dhe do të bëhet pronar i një numri të caktuar kuotash në momentin që kryen pagesën në favor të llogarisë së Fondit. Periudha e investimit fillon në momentin e ardhjes së pagesës në fond dhe zgjat deri në ditën e mbërritjes së një kërkese të vlefshme për shitjen e kuotave në Raiffeisen Invest sh.a.

Periudha minimale e investimit rekomandohet të jetë të paktën 5 vjet.

Çmimi i blerjes së kuotës do të jetë çmimi i zbatueshëm në ditën e kryerjes së pagesës në Fond, i llogaritur në përputhje me ligjin nr. 56/2020 « Për sipërmarrjet e investimeve kolektive », rregulloret në zbatim të tij, si dhe në përputhje me këtë prospekt.

Nëse kërkesa për blerjen e kuotave mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste zyrtare, çmimi i blerjes së kuotave do të jetë ai i ditës së parë pasardhëse të punës. Numri i kuotave në Fond përcaktohet me 4 shifra pas presjes dhjetore.

3.7.2 Shlyerja e kuotave

Mbajtësit e kuotave kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shitjen e kuotave të tyre. Investitori do të plotësojë një kërkesë për shitje të kuotave të Fondit Furnizues pranë njërës prej degëve të Raiffeisen Bank sh.a.

Shlyerja e kuotave në Fondin Furnizues bëhet nga Shoqëria Administruese me një çmim të zbatueshëm në:

- Ditën e mbërritjes së një kërkese të vlefshme për shitje, nëse kërkesa e vlefshme është procesuar deri në orën 13:00 të asaj dite
- Ditën e parë pasardhëse të punës pas ditës së mbërritjes së një kërkese të vlefshme për shitje, nëse kjo e fundit është procesuar pas orës 13:00 të asaj dite.

Në momentin e shlyerjes, asetet monetare të investitorit do të kalojnë nga llogaria e fondit furnizues pranë bankës depozitare drejt llogarisë së investitorit në një bankë të nivelit të dytë. Kryerja e pagesës në asete monetare, nga llogaria e Fondit Furnizues në llogarinë e investitorit do të bëhet brenda 7 ditëve kalendarike nga dita e mbërritjes së kërkesës së vlefshme për shitje në Raiffeisen Invest, dhe do të jetë subjekt i komisioneve të transfertës nga banka pritëse që lidhen me afatin e shlyerjes, me përjashtim të rasteve kur Shoqëria Administruese, në mbrojtje të interesave të investitorëve ka aktivizuar shtyrjen e afatit të shlyerjes si mjet i manaxhimit të likuiditetit të parashikuar në seksionin 3.4.1 të Prospektit.

Nëse kërkesa për shitjen e kuotave mbërrin gjatë fundjavës ose në një ditë feste, dita e kërkesës së vlefshme për shitje do të jetë dita e parë pasardhëse e punës.

3.8 Këmbimi i kuotave

Mbajtësit e kuotave të Fondit Furnizues mund t'i këmbejnë ato me kuota të një fondi tjetër investimi, në të njëjtën monedhë, të manaxhuar nga e njëjta shoqëri administruese, duke respektuar vlerat e shumës minimale të investimit dhe të shumës minimale të mbetur në fond.

Çdo investitor që dëshiron të këmbejë kuota në fond, do të nënshkruajë një kërkesë për këmbim kuotash.

Për këmbimin e kuotave, numri i Kuotave të reja të blera do të përcaktohet duke iu referuar çmimeve përkatëse të Kuotave të Reja dhe Kuotave fillestare në momentin e vlerësimit.

Asnjë këmbim nuk do të kryhet gjatë periudhës kur e drejta e investitorëve për të kërkuar shlyerje të kuotave është pezulluar. Këmbimi i kuotave midis dy fondeve të investimit do të kryhet vetëm në një ditë pune kur të dy fondet kanë mundur të nxjerrin çmimet përkatëse të kuotave.

Efekti fiskal i këmbimit të kuotave është i njëjtë si në rastin e shitjes së tyre nga investitori (shlyerjes nga fondi).

3.9 Transferimi i kuotave të fondit

Çdo investitor i Fondit Furnizues ka të drejtë t'i transferojë kuotat që zotëron nëpërmjet një akti transferimi të përcaktuar nga shoqëria administruese, me përjashtim të rastit kur transferimi është në kundërshtim me kuadrin rregullator.
Çdo akt transferimi në lidhje me kuotat e Fondit Furnizues nënshkruhet nga investitori që zotëron kuotat në fond ose përfaqësuesi i subjektit juridik dhe transferuesi trajtohet si pjesëmarrës në fond deri në momentin kur marrësi i kuotave të jetë regjistruar nga shoqëria administruese dhe depozitari. Transferimi i kuotave është subjekt tatimi sipas legjislacionit në fuqi.
Shoqëria administruese do të aplikojë tarifë transferimi e cila do të rishikohet çdo vit.

3.10 Pezullimi i shitjes dhe i shlyrjes së kuotave në Fondin Furnizues

Shitja dhe shlyerja e kuotave në Fondin Furnizues mund të pezullohet në rastet kur:

Shoqëria administruese dhe depozitari vlerësojnë se në bazë të rrethanave të jashtëzakonshme ka arsye të forta e të justifikuara, për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes, në mbrojtje të interesit të mbajtësve ekzistues dhe potencial të kuotave.

- Shoqëria administruese, njofton menjëherë AMF-në lidhur me vendimin për pezullimin e shitjes dhe të shlyerjes së kuotave. AMF-ja, pas marrjes së njoftimit, mund të urdhërojë anullimin e këtij vendimi, nëse gjykon se është në interes të publikut ose në interes të investitorëve në fond. Shoqëria administruese publikon, në faqen zyrtare të internetit, në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe me çdo mjet të qëndrueshëm komunikimi, arsyet e pezullimit si dhe detaje të mjaftueshme për mbajtësit e kuotave në mënyrë që të kenë të gjithë informacionin e duhur në lidhje me pezullimin.

  Pezullimi i shitjes dhe shlyerjes merr fund sapo të përfundojnë së ekzistuari arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes, por jo më vonë se brenda njëzet ditëve punë nga pezullimi, me përjashtim të rastit kur Autoriteti ka dhënë pëlqimin me shkrim për shtyrjen e këtij afati. Shoqëria administruese informon Autoritetin menjëherë me të rifilluar shitjen dhe shlyerjen, dhe rifillimi i shitjes dhe shlyerjes së kuotave publikohet nga shoqëria administruese në një gazetë të përditshme, me qarkullim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në faqen e internetit të shoqërisë administruese.

- AMF-ja vlerëson se ekzistojnë shkaqe të forta dhe të justifikuara, nëse kjo është në mbrojtje të interesave të mbajtësve ekzistues ose potencial të kuotave, si dhe në rastet e forcës madhore, duke urdhëruar shoqërinë administruese dhe depozitarin të pezullojë përkohësisht shitjen dhe shlyerjen e tyre. AMF publikon në faqen zyrtare të saj, arsyet dhe kohëzgjatjen e pezullimit, në rastet kur kjo e fundit dihet. Ky pezullim mund të jetë me afat të caktuar ose pa afat.

- Gjatë periudhës kur nuk ka shoqëri administruese ose depozitar, apo kur shoqëria administruese ose depozitari vendoset në likuidim ose shpallet e falimentuar ose hyn në procedurë likuidimi ose është objekt i procedurave të ngjashme.

- Fondi Furnizues mund të pezullojë të drejtën e shlyerjes ose shitjes së kuotave në të njëjtën masë siç bëhet nga Fondi Kryesor.

Rifillimi i shitjes dhe shlyerjes kryhet menjëherë sapo pushojnë së ekzistuari arsyet për pezullimin e shitjes dhe shlyerjes.

3.11 Administrimi i pjesës së fitimit për mbajtësit e kuotave

Kuotat e Fondit Furnizues janë kuota akumulimi, që do të thotë kuota për të cilat të ardhurat nga investimi ri-investohen automatikisht dhe përfitimi tek investitorët vjen prej akumulimit të vlerës së këtyre kuotave. Fitimi nga investimi në fond reflektohet në rritjen e çmimit të kuotës. Investitori mund ta tërheqë fitimin nëpërmjet shitjes së plotë ose të pjesshme të kuotave, në përputhje me dispozitat ligjore dhe këtë prospekt.

3.12 Metodologjia dhe frekuenca e vlerësimit të aseteve dhe çmimit për kuotë

Shoqëria Administruese llogarit vlerën totale të aseteve të Fondit Furnizues, përcakton detyrimet e tij dhe llogarit vlerën neto të aseteve të Fondit Furnizues, si edhe vlerën neto të aseteve për kuotë. Këto llogaritje bëhen në bazë ditore. Depozitari kontrollon dhe konfirmon llogaritjen e këtyre vlerave dhe është përgjegjës për saktësinë e tyre. Metoda e vlerësimit të aseteve dhe detyrimeve financiare të Fondit bazohet në dispozitat e Ligjit nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe rregulloreve në zbatim të tij, si edhe në parimet e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Mbështetur në sa më sipër, si dhe në metodologjinë « Për llogaritjen e vlerës neto të aseteve të fondeve në Euro » të dakordësuar nga Shoqëria Administruese dhe Depozitari:

- Të ardhurat e interesit nga depozitat do të llogariten në bazë ditore, por pagesa do të bëhet në datën e maturimit të depozitës. Baza për llogaritjen e interesit është 360 ditë, dhe interesi fillon në datën e emetimit siç është rënë dakord në transaksion.

- Çdo depozitë në datën e emetimit T dhe maturitet në datën N, do të gjenerojë interes nga data T deri në datën (N-1), por pagesa e interesit nga pala tjetër do të jetë në datën N.

- Kuotat e Fondit Kryesor për ditën e vlerësimit (T) do të vlerësohen sipas çmimit zyrtar të disponueshëm në ditën e llogaritjes së vlerës neto të aseteve për kuotë (T+1). Kjo mënyrë shmang strategjinë e parashikimit të tregut, duke parandaluar mundësitë e arbitrazhit.
  Në rastin kur vlera neto e aseteve për kuotë nuk është publikuar ose nuk është e disponueshme në ditën e vlerësimit, kuotat e investuara në Fondin Kryesor do të rivlerësohen me çmimin më të fundit të publikuar për atë fond.

- Marrëveshjet e riblerjes vlerësohen nga dita e fillimit të transaksionit, në mënyrë që titujt që janë objekt, të vazhdojnë të vlerësohen në përputhje me rregullat e zbatueshme të llojit të titullit, ndërsa pasivet për fondet e mjeteve monetare të marra vlerësohen përmes llogaritjes së normës së interesit.
  Marrëveshjet e anasjellta të ri-blerjes vlerësohen nga dita e fillimit të transaksionit, njësoj si depozitat, përmes llogaritjes ditore të interesit.
  Baza e llogaritjes së interesit është 360 ditë.

- Titujt e tregtuar në tregje aktive, do të vlerësohen nga dita e transaksionit në bazë të metodës së çmimit të tregut (mark to market) duke u bazuar në ofertën blerëse në mbyllje të tregjeve (bid close). Nëse titujt tregtohen në tregje jo-aktive, vlerësimi do të mbështetet në metodën mark to model, e cila është dakordësuar me bankën depozitare dhe përllogarit normën e tregut (market yield), sipas ditëve të mbetura deri në maturim (YTM) dhe bazuar mbi kurbën e yield-eve për instrumenta të ngjashëm.

Vlera e kuotës së Fondit në ditën e vlerësimit (T-1) përcaktohet duke pjesëtuar vlerën neto të aktiveve të Fondit në euro të asaj dite (T-1) me numrin e përgjithshëm të kuotave për atë ditë (T-1). Numri total i kuotave të fondit të investimit Raiffeisen Solid EUR, në ditën e vlerësimit (T-1), llogaritet duke i shtuar numrit të përgjithshëm të kuotave në ditën para ditës së vlerësimit (T-2) numrin e kuotave të blera në ditën e vlerësimit (T-1) dhe duke i zbritur numrin e kuotave të shlyera në ditën e vlerësimit (T-1).

$$\text{Çmimi FINAL} = \frac{\text{Vlera Totale e Aseteve në ditën (T-1) - detyrimet pas rillogaritjeve}}{\text{Nr. i kuotave në ditën (T-1)}}$$

Dita e vlerësimit të aktiveve të Fondit (T-1) do të jetë një ditë para ditës (T) gjatë së cilës kryhet llogaritja e vlerës neto të aktiveve për kuotë. Depozitari ka detyrimin që të informojë AMF-në në lidhje me përllogaritjen e vlerës neto të aktiveve të Fondit dhe çmimit për kuotë çdo ditë, ndërsa shoqëria administruese publikon në faqen zyrtare të internetit çdo ditë çmimin e kuotës së fondeve dhe vlerën neto të aktiveve pas rakordimit dhe konfirmimit me depozitarin e fondit.

3.13 Informimi i investitorëve

Shoqëria administruese është e detyruar t'i paraqesë rregullisht AMF-së raportime për veprimtarinë e saj të brendshme, si dhe për administrimin Fondit Furnizues duke respektuar afatet kohore të përcaktuara në Ligj.

Këto raporte së bashku me informacionin shtesë mbi fondin, do të vihen në dispozicion të investitorëve pranë zyrave qëndrore të shoqërisë administruese (Rr.Abdyl Frashëri, EGT Tower, Pall.11/1, Kati 3, Tiranë) ose nëpërmjet postës elektronike pas një kërkese me shkrim.

Prospekti i Fondit Furnizues do të jetë i disponueshëm pa pagesë, në gjuhën shqipe pranë degëve të Raiffeisen Bank Sh.a, si dhe në faqen zyrtare të internetit të Raiffeisen Invest sh.a.

Çdo ndryshim thelbësor i prospektit, sipas legjislacionit në fuqi, i njoftohet të gjithë investitorëve nëpërmjet postës elektronike dhe publikohet në faqen zyrtare të shoqërisë administruese për një periudhë prej 60 ditësh gjatë së cilës investitorët kanë të drejtë të kërkojnë shitje të kuotave të tyre.

Të gjitha informacionet e mësipërme, përfshirë çmimin e kuotës, vlerën neto të aseteve të fondit, ndryshimet jo thelbësore të prospektit (si psh. ndryshime të tarifave të fondit brenda kufijve të miratuar në prospekt), adresën e shoqërisë apo informacione të tjera do të publikohen në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese.

Në mënyrë që të sigurohet informacioni i nevojshëm dhe në kohë, investitori ka detyrimin të njoftojë shoqërinë administruese për çdo ndryshim në të dhënat e tij të kontaktit si: adresë, nr. tel. etj.

3.14 Likuidimi, mbyllja e fondit kryesor dhe fondit furnizues

3.14.1 Likuidimi, mbyllja dhe bashkimi i fondit kryesor

Nëse Fondi Kryesor mbyllet dhe likuidohet, Fondi Furnizues duhet të mbyllet dhe likuidohet, nëse Autoriteti nuk miraton kalimin e investimit në një tjetër Fond Kryesor ose nuk miraton ndryshimin e Fondit Furnizues në një sipërmarrje të investimeve kolektive me ofertë publike, që nuk funksionon si Fond Furnizues.

Në rastin e bashkimit të fondit kryesor, Autoriteti mund të japë miratimin që investimi të vijojë në subjektin e bashkuar.

Sipërmarrja kryesore mbyllet dhe likuidohet jo më parë se tre muaj, pasi ka informuar mbajtësit e kuotave dhe autoritetin rregullator të vendit të origjinës të sipërmarrjes furnizuese për vendimin e mbylljes.

3.14.2 Likuidimi dhe mbyllja e fondit furnizues

Shoqëria administruese mund të iniciojë likuidimin vullnetar të Fondit Furnizues, kur krijohen rrethanat e parashikuara në ligjin nr. 56/2020 «Për sipërmarrjet investimeve kolektive» dhe në mënyrë të veçantë kur:

- Fondi Furnizues nuk është ekonomikisht i qëndrueshëm dhe nuk përmbush qëllimin e tij;
- Fondi Kryesor mbyllet dhe likuidohet;
- Në rast të përfundimit të detyrave të depozitarit ose shoqërisë administruese të fondit të investimeve, nëse ato nuk zëvendësohen brenda 60 ditëve pune;
- Shoqëria administruese mbyll vullnetarisht aktivitetin e saj;
- Shoqëria administruese i nënshtrohet procedurave të falimentit dhe likuidimit si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve;

Fondi Furnizues likuidohet në momentin e heqjes së licencës nga autoriteti.

3.14.2.1 Kërkesa për likuidimin vullnetar të fondit furnizues

Kërkesa për likuidimin vullnetar të Fondit Furnizues i paraqitet AMF-së nga Shoqëria Administruese jo më pak se 3 (tre) muaj,përpara datës së propozuar të likuidimit.

Kërkesa që i paraqitet AMF-së për likuidimin vullnetar të Fondit Furnizues perfshin arsyet e kërkesës dhe një plan kohor për likuidim.

Mbajtësit e kuotave informohen lidhur me likuidimin vullnetar pas dhënies së miratimit nga AMF; Ky informacion përfshin:

a. arsyet e likuidimit;
b. pasojat e mundshme për mbajtësit e kuotave;
c. kostot përkatëse;
d. pasqyrat e aftësisë paguese;
e. datën e planifikuar të përfundimit të likuidimit vullnetar, përfshirë datën kur mbajtësit e kuotave do të kenë pagesën e vlerës së kuotave.

3.14.2.2 Procedurat e likuidimit vullnetar dhe mbylljes së fondit furnizues

Në rastin e mbylljes së Fondit Furnizues, zbatohen procedurat e mëposhtme:

a. Njoftimi i mbylljes ose likuidimit vullnetar u dërgohet menjëherë mbajtësve të kuotave,si dhe Fondit Kryesor;
b. Ndërpritet vlerësimi dhe vendosja e çmimit;
c. Fondi Furnizues pushon së emetuari ose anulluari kuota, me përjashtim të anullimit përfundimtar;
d. Fondi Furnizues nuk ushtron asnjë lloj veprimtarie, me përjashtim të veprimtarisë së mbylljes;
e. Përgjegjësitë dhe detyrimet e shoqërisë administruese vijojnë të zbatohen deri në përfundim të mbylljes.

3.15 Tarifa dhe komisione

3.15.1 Komisione/tarifa të njëhershme përpara ose pas investimit

- **Komisioni i hyrjes**
  Shoqëria administruese nuk do të ngarkojë investitorin me komision hyrjeje në momentin e blerjes së kuotave. Sidoqoftë, investitori mund të jetë subjekt i tarifave bankare për transferimin e fondeve drejt bankës depozitare (për referencë, neni 3.7.1. i këtij prospekti).

- **Komisioni i daljes**
  Për çdo shitje apo këmbim të kryer përpara përfundimit të periudhës minimale të investimit prej 2 vitesh, për investimin përkatës, do të aplikohet një tarifë dalëse deri në 1.00%, e cila përllogaritet si përqindje e shumës së shlyer/këmbyer. Tarifa dalëse dhe çdo ndryshim i saj publikohen në faqen zyrtare të internetit të shoqërisë administruese, së bashku me datën e hyrjes në fuqi. Në kushtet kur tarifa dalëse ndryshon, tarifa e re është e vlefshme vetëm për investitorët që investojnë në Fond pas momentit të hyrjes së saj në fuqi. Nga kjo tarifë përjashtohen investitorët që transferojnë kuotat e tyre tek një apo disa investitorë të tjerë brenda të njëjtit fond. Për përfituesin e kuotave nga transferimi, i cili është investitor ekzistues në fond, periudha minimale e investimit prej 2 vitesh do të llogaritet nga data e përfitimit të kuotave të transferuara.

Tarifa dalëse do të llogaritet dhe aplikohet në momentin e shitjes apo këmbimit të kuotave si më poshtë:
Tarifa dalëse e raportuar x shuma e shlyer/këmbyer përpara përfundimit të periudhës minimale të investimit prej 2 vitesh.

Të gjitha të ardhurat nga tarifa dalëse rikthehen në fond dhe shpërndahen si e ardhur tek të gjithë anëtarët e mbetur në fond, në përpjesëtim me shumën që ata kanë investuar në fond.

Për të caktuar se cilat kuota janë subjekt i tarifës dalëse, përdoret metoda "first in, first out" ("FIFO), sipas së cilës kuotat që blihen të parat shlyhen të parat dhe kuotat që blihen të fundit, shlyhen të fundit.

3.15.2 Komisione/tarifa që paguhen nga asetet e fondit

- **Komisioni vjetor i administrimit**
  Komisioni vjetor i administrimit që u ngarkohet mbajtësve të kuotave të Fondit është deri në 1.3% e vlerës neto të aseteve të fondit. Ky komision përllogaritet çdo ditë dhe zbritet nga asetet e fondit, ndërsa pagesa e tij për shoqërinë administruese kryhet një herë në muaj.

- **Kostot e transaksioneve**
  Kjo i referohet atyre kostove apo komisioneve që lidhen me blerjen dhe shitjen e aktiveve të fondit të investimit.

- **Kostot për auditorin**
  Shpërblimi për auditorin është përcaktuar në kontratën e lidhur midis shoqërisë administruese dhe Auditorit, e cila miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

- **Tarifat rregullatore**
  Të gjitha tarifat që i paguhen Autoritetit Mbikëqyrës për Fondin, do t'i ngarkohen fondit.

- **Tarifat dhe kostot e depozitarit**
  Tarifat dhe kostot e depozitarit për shërbimet e ofruara do t'i ngarkohen Fondit. Tarifat e zakonshme të kujdestarisë për ruajtjen e instrumenteve financiare (aty ku është e aplikueshme përfshihen edhe tarifat për ruajtjen e titujve dhe instrumenteve financiare jashtë Shqipërisë që depozitari ja ka deleguar një kujdestari) mund të zbriten nga fondi (tarifat e kujdestarisë). Fondi do të ngarkohet edhe me tarifat për shërbime të tjera të ofruara nga depozitari/kujdestari.

- **Kostot e komunikimit të ndryshimeve në prospekt**
  Kostoja totale që paguhet nga asetet e Fondit llogaritet çdo vit për vitin paraardhës dhe publikohet në raportet financiare vjetore ose të ndërmjetme të audituara si dhe në Informacionin Kryesor për Investitorin, në përputhje me kërkesat ligjore. Kostot totale që paguhen nga asetet e fondit në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë 3,5% në vit të vlerës neto të aseteve të fondit.

3.15.3 Komisione/tarifa që paguhen nga mbajtësit e kuotave (investitori)

- **Komision këmbimi**
  Shoqëria administruese nuk do t'u ngarkojë mbajtësve të kuotave komision këmbimi në rastet e këmbimit të kuotave midis fondeve të investimit në të njëjtën monedhë, të administruar nga shoqëria administruese.

- **Kostot e shpërndarjes së raporteve dhe pasqyrave financiare vjetore dhe të ndërmjetme tek investitorët e fondit sipas kërkesës së tyre;**

- **Kostot e shërbimit të mbajtësve të kuotave** si kostot e lëshimit të certikatave ose vërtetimeve mbi pronësinë e kuotave apo pasqyrën e llogarisë në Fond.

- **Tarifa e transferimit** i ngarkohet mbajtësit të kuotave që urdhëron transferimin dhe aplikohet si në rastin e transferimit të kuotave tek investitorët e rinj ashtu edhe tek investitorët ekzistues në fond.

Çdo tarifë marketimi ose shitjeje e fondit paguhet nga shoqëria administruese.

Shoqëria administruese mund të ndryshojë tarifat e Fondit në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe rregulloreve të dala në zbatim të tij. Çdo ndryshim tarifash do të reflektohet në ndryshime në prospektin e Fondit, i cili miratohet paraprakisht nga AMF-ja dhe i njoftohet mbajtësve të kuotave në përputhje me paragrafin 3.13 të këtij prospekti

3.16 Trajtimi fiskal i fondit furnizues dhe investitorit

Fondi Furnizues për qëllime tatimi, konsiderohet si pronari i titujve ose i të gjitha aseteve, si dhe personi i fundit që përfiton prej saj, përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin tatimor.

Të gjitha fitimet e realizuara nga investimi në Fondin Furnizues do të tatohen sipas legjislacionit tatimor në fuqi, në momentin e shlyerjes së kuotave. Tatimi mbahet në burim nga shoqëria administruese.

Shënim:
Dispozitat fiskale pasqyrojnë situatën aktuale ligjore. Efektet fiskale varen nga situatat personale të investitorit dhe mund të jenë subjekt ndryshimesh në të ardhmen. Kështu, vlerësimi fiskal mund të ndryshojë si rezultat i ndryshimeve në legjislacion, vendimeve të gjykatës ose akteve të tjera nënligjore të administratës Tatimore. Për këto arsye, përpara se të blejnë apo shesin kuota në fond, ne i rekomandojmë investitorët që të këshillohen me një këshilltar fiskal mbi pasojat që mund të kenë sipas situatës së tyre personale.

3.17 Viti financiar

Viti financiar për Fondin Furnizues fillon më 01 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

3.18 Audituesi i Jashtëm

Audituesi i jashtëm i fondit është RSM Albania Sh.p.k., me seli në adresën:
Rruga Skënder Luarasi, sheshi Gjenerali Jozef San Martin, Pallati 3, Hyrja 19, Tiranë, Shqipëri.

Web: https://www.rsm.global/albania/

Personat përgjegjës:
Përfaqësuar nga: Elona Bisha (Administrator) - E-mail: Elona.bisha@rsm.al
Personi kontaktues sekondar: Fatian Devija (Partner) – E-mail: fatian.devija@rsm.al

Audituesi i Jashtëm miratohet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

4 Depozitari i fondit

Shoqëria administruese ka lidhur një marrëveshje për shërbimin e depozitarit me Bankën e Parë të Investimeve, Albania sh.a. me seli në adresën: Bul. "Dëshmoret e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë.

Depozitari është licencuar nga Banka e Shqipërisë për të ofruar shërbimet e kujdestarisë, depozitimit dhe të besimit me Vendimin nr.13 datë 10/03/2010 si dhe është licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për të ofruar shërbime depozitimi për fondet e pensionit me Vendimin nr. 80, datë 30.08.2010 dhe për sipërmarrjet e investimeve kolektive me Vendimin nr.1, datë 13.12.2011.
Veprimtaria e mbajtjes së aseteve dhe veprimtari të tjera, të zhvilluara nga depozitari, për shoqërinë administruese, për sa i përket strukturës organizative, veçohen nga veprimtaria e shoqërisë administruese.

Asetet e Fondit Furnizues, përfshirë llogaritë bankare dhe asete të tjera, ruhen dhe mbahen nga depozitari në një llogari të posaçme dhe nuk mund të përdoren as drejtpërdrejt, as në mënyrë të tërthortë për kryerjen e transaksioneve për llogari të tij, ose për të marrë ndonjë përfitim për vete a punonjësit e tij, apo për qëllime të tjera, përveç përfitimit të mbajtësve të kuotave
Asetet e Fondit Furnizues, që mbahen nga depozitari, kanë të drejtën e veçimit, si dhe nuk përfshihen në asetet e depozitarit, në procedurat e likuidimit ose të falimentimit, të nisura sipas legjislacionit shqiptar dhe as për zbatimin e pretendimeve ndaj depozitarit.
Depozitari vepron vetëm në interes të mbajtësve të kuotave të Fondit.

Përveç ruajtjes së aseteve të Fondit Furnizues, depozitari ka detyrimet e mëposhtme:

1. garanton se shitja, emetimi, riblerja, shlyerja dhe anulimi i kuotave janë në përputhje me ligjin dhe rregullat e fondit;
2. siguron se vlera neto e aktiveve të kuotave në Fondin Furnizues është llogaritur në përputhje me ligjin dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në bazë të tij;
3. përmbush dhe zbaton udhëzimet e shoqërisë administruese nëse nuk bien ndesh me ligjin, aktet rregullative të miratuara nga autoriteti;
4. garanton kthimin e çdo shume përkatëse në Fondin Furnizues , brenda afateve kohore të përcaktuara lidhur me transaksionet që përfshijnë aktivet e Fondit;
5. garanton se të ardhurat e Fondit Furnizues përdoren në përputhje me Ligjin dhe rregullat e fondit
6. garanton që flukset monetare të Fondit Furnizues të monitorohen si duhet, në veçanti garanton se janë arkëtuar të gjitha pagesat e bëra nga investitorët, ose në emër të investitorëve, me nënshkrimin e kuotave, dhe se të gjitha mjetet monetare të Fondit Furnizues janë regjistruar në llogaritë e mjeteve monetare në emër të Fondit Furnizues, shoqërisë administruese për llogari të Fondit Furnizues, ose të depozitarit për llogari të Fondit Furnizues;
7. lidhur me llogaritë e hapura, në bazë të parag. 6 më sipër, depozitari merr masat e nevojshme për të siguruar që asetet monetare të Fondit Furnizues të depozitohen pranë një banke qendrore, një banke në Republikën e Shqipërisë apo një banke të licencuar në një vend tjetër, të mbajtur në një llogari ose disa llogari të identifikuara më vete nga çdo llogari që përdoret për të mbajtur fondet që i përkasin depozitarit apo fondeve të klientëve të tjerë të depozitarit;
8. kur llogaritë monetare hapen në emër të depozitarit, i cili vepron për llogari të Fondit Furnizues, në këto llogari nuk kontabilizohet asnjë mjet monetar i veti i depozitarit apo i subjekteve të përmendura në parag. 7 më sipër;
9. emeton e anulon kuotat dhe paguan paratë e shlyerjes mbajtësve të kuotave, sipas udhëzimeve të shoqërisë administruese, kur këto udhëzime janë në përputhje me ligjin dhe aktet rregullative të miratuara nga autoriteti në zbatim të tij;
10. monitoron përputhshmërinë e investimeve dhe huamarrjes së sipërmarrjes së investimeve kolektive me Ligjin dhe aktet nënligjore;
11. mban regjistrin e mbajtësve të kuotave dhe shërbimet e transferimit ;
12. i raporton shoqërisë administruese të fondeve për veprimet tregtare lidhur me aktivet e Fondit të mbajtura në kujdestari dhe ekzekuton udhëzimet e saj.

Depozitari njofton me shkrim Autoritetin, menjëherë nëse pas një shqyrtimi të fakteve që ka në dispozicion ose të rrethanave, ka arsye për të besuar se shoqëria administruese e fondit ka shkelur ligjin ose prospektin dhe rregullat e fondit.

4.1 Konflikti i interesit

Depozitari nuk kryen veprimtari lidhur me Fondin Furnizues ose me shoqërinë administruese që administron fondin, të cilat mund të shkaktojnë konflikt interesi, me përjashtim të rastit kur depozitari ka bërë një ndarje funksionale dhe hierarkike të kryerjes së detyrave të depozitarit nga detyrat e tjera që përbëjnë konflikt dhe nëse konflikti i mundshëm i interesit identifikohet, administrohet dhe monitorohet në mënyrë të përshtatshme.

Depozitari nuk zotëron licencë si shoqëri administruese.

Kur Depozitari kryen transaksione me subjekte të lidhura ose persona fizikë të lidhur vendos në zbatim politika dhe procedura të cilat garantojnë se: a) identifikohen të gjitha konfliktet e interesit të lindura nga këto transaksione; b) ndërmerren të gjithë hapat e arsyeshëm për t'i shmangur këto konflikte interesi.

Kur nuk mund të shmanget konflikti i interesit, shoqëria administruese dhe depozitari administrojnë, monitorojnë dhe bëjnë të ditur këtë konflikt interesi, në mënyrë që të parandalohet çdo pasojë e padëshirueshme në interesat e Fondit Furnizues dhe të investitorëve të tij.

5 Informacion plotësues

Informacioni në këtë Prospekt bazohet në ligj dhe në praktikat më të mira. Çdo person që lexon këtë Prospekt, duhet të verifikojë pranë Raiffeisen Invest sh.a. ose në çdo degë të Raiffeisen Bank sh.a. se ky është versioni më i fundit dhe se nuk janë bërë rishikime apo ndryshime të tjera që nga momenti që ky Prospekt ka dalë në qarkullim.

5.1 Etika dhe konflikti i interesit

Punonjësit e përfshirë në procesin e investimit të aseteve nuk duhet të kenë paralelisht një aktivitet apo biznes personal, i cili mund të jetë në konflikt me manaxhimin e investimeve në mënyrën e duhur, apo që mund të kufizojë aftësinë e tyre për të marrë vendime të paanshme.

5.2 Kujdesi

Manaxhimi i portofolit të Fondit Furnizues do të bëhet duke implementuar "Rregullin e personit të kujdesshëm". Ky rregull detyron manaxherin e fondit që të veprojë dhe investojë me të njëjtin gjykim, kujdes e mençuri, me të cilin do të vepronte një person i kujdesshëm që po manaxhon asetet e tij; jo për motive spekulimi, por për një motiv të pastër investimi, duke konsideruar mundësitë e ruajtjes së kapitalit dhe mundësinë e të ardhurave që do të fitonte si rezultat i këtij investimi.

Fondi Furnizues do të manaxhohet me profesionalizëm, të denjë për besimin e publikut.

5.3 Statusi "Fatca"

Bazuar në angazhimet e Grupit Raiffeisen, për të qenë në përputhje me legjislacionin fiskal të SHBA, në veçanti me FATCA ("Foreign Account Tax Compliane Act"), Fondi Furnizues do të regjistrohet në Agjencinë Amerikane të të Ardhurave (IRS: US Internal Revenue Service). Shoqëria administruese do t'i njoftojë investitorët, lidhur me numrin unik (GIIN) për qëllime të FATCA, bazuar në kërkesën e tyre.

Kështu, fondi konsiderohet "Institucion Financiar i Huaj (FFI) Pjesëmarrës" lidhur me zbatimin e FATCA.

5.4 Shkëmbimi automatik i informacionit të llogarive financiare

Raiffeisen Invest sh.a., zbaton kërkesat e Ligjit nr. 4 datë 30.01.2020 "Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare". Të gjithë investitorëve që duan të hapin një llogari të re, u kërkohet të plotësojnë një formë Vetëdeklarimi me të dhënat e tyre personale dhe tatimore, si dhe numrin përkatës të Identifikimit për qëllime fiskale. Sipas këtij ligji, institucioneve financiare, përfshirë Raiffeisen Invest sh.a., u kërkohet të raportojnë llogaritë financiare të klientëve të cilët janë rezidentë për qëllime tatimore në një juridiksion pjesëmarrës në Standardin e Përbashkët të Raportimit të vendosur nga OECD.

5.5 Ankesat

Nëse keni një ankesë, lutemi dërgojeni atë me shkrim në adresën e shoqërisë administruese, tek Rr.Abdyl Frashëri, EGT Tower, Pall.11/1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri ,ose plotësoni një formular ankese pranë çdo dege të Raiffeisen Bank. Të gjitha ankesat do të shqyrtohen, dhe do t'u jepet një përgjigje brenda 2 javëve nga data e mbërritjes së tyre.

5.6 Ekzekutimi optimal i vendimeve të tregtimit

Në përputhje me "Politikën e ekzekutimit më të mirë" të zbatuar nga shoqëria administruese, ekzekutimi optimal i vendimeve të tregtimit udhëhiqet nga parimet e mëposhtme:

5.6.1 Kriteret e ekzekutimit

Për sa i përket transaksioneve specifike, kriteret e mëposhtme janë të rëndësishme për të arritur në mënyrë të vazhdueshme rezultatet më të mira të mundshme të ekzekutimit për fondin ose portofolin në terma afatgjatë: norma e interesit / çmimi, tarifat / kostot, natyra / madhësia e transaksionit, shpejtësia e ekzekutimit, probabiliteti i ekzekutimit dhe procesi i shlyerjes.

Duke marrë parasysh kriteret më të mira të ekzekutimit dhe për të përcaktuar rëndësinë e tyre relative, konsiderohen elementët e mëposhtëm: karakteristikat e fondit siç janë objektivi i investimit, politika e investimit dhe profili i riskut të fondit; karakteristikat e urdhërit të dhënë; karakteristikat e instrumenteve financiare që janë subjekt i këtij urdhëri; karakteristikat e vendeve të ekzekutimit të cilave mund t'u drejtohet ai urdhër; gjendja e likuiditetit në kohën e ekzekutimit.

Shoqëria administruese pas përfundimit të çdo transaksioni kontrollon nëse transaksioni i kryer është konform me të dhënat e tregut.

5.6.2 Përzgjedhja e ndermjetësve/ palëve

Raiffeisen Invest siguron të ketë marrëdhënie të mira me partnerë me reputacion të lartë, me qëllim që të maksimizojë cilësinë e ekzekutimit në raport me vlerën e kostos së ekzekutimit.

Përzgjedhja e partnerëve tregtarë (ndërmjetësve), të cilëve mund t'u përcillen urdhërat, bëhet në bazë të kritereve të paracaktuara. Në veçanti, konsiderohen kriteret e mëposhtme: shpejtësia e ekzekutimit, volumi i tregtuar, aftësia për t'u kryer pa probleme dhe në kohën e duhur, sigurimi i ekzekutimit optimal të urdhërave, informacioni për tregun (informacioni teknik), reputacioni i ndërmjetësit.

Pas fillimit të marrëdhënieve të biznesit, partnerët e tregtimit i nënshtrohen rishikimeve të rregullta nga shoqëria administruese.

5.6.3 Vendet e ekzekutimit

Për instrumentet e tregut të parasë siç janë depozitat, transaksione të Marrëveshjes së Riblerjes / të anasjelltë të Riblerjes, renditja e mëposhtme e faktorëve të ekzekutimit konsiderohet kur vendoset për një palë:

1. Norma e interesit
2. Vlerësimi i kreditit të Palës
3. Mundësia e ekzekutimit dhe procesi i shlyerjes
4. Natyra / madhësia e transaksionit
5. Tarifat / kostot

Urdhrat për blerjet ose shlyerjet e kuotave të Fondit Kryesor kryhen përmes Bankës së Parë të Investimeve në cilësinë e saj si banka depozitare. Këto urdhra ekzekutohen në përputhje me dispozitat përkatëse të Prospektit të Fondit Kryesor.

Prospekti i parë i fondit u miratua nga Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 47, datë 28.03.2024.
Ky është Prospekti i përditësuar, i publikuar në Korrik 2025.

Aneksi 1
Rregullat e Fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid

Neni 1 : Objekti i Rregullave të Fondit Furnizues
1.1 Rregullat e Fondit Furnizues rregullojnë kushtet e veprimtarisë së Fondit Furnizues (në vijim referuar si "Fondi Furnizues"), sipërmarje e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, në tituj të transferueshëm, themeluar nga Raiffeisen Invest- Shoqëri Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.Për më tepër ato rregullojnë marrëdhëniet ligjore ndërmjet Raiffeisen INVEST sh.a. (në vijim referuar si "Shoqëria Administruese") si dhe kuota-mbajtësve në Fondin Furnizues(në vijim referuar si "Investitorët").

1.2 Rregullat e Fondit Furnizues nuk përmbajnë detyrimisht të gjithë informacionin dhe të dhënat të paraqitura në prospekt. Investitorët këshillohen të studiojnë të gjithë përmbajtjen e prospektit.

Neni 2 : Struktura juridike e Fondit Furnizues
Fondi Furnizues është një sipërmarrje e investimeve kolektive me pjesëmarrje të hapur me ofertë publike, në tituj të transferueshëm, e krijuar nga Raiffeisen Invest sh.a.

Neni 3 : Krijimi dhe Kohëzgjatja e Fondit Furnizues
Fondi Furnizues është krijuar më 28.03.2024, është miratuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare me vendimin Nr. 47, Licencë nr.14.
Fondi u krijua si një Fond Furnizues i Fondit Kryesor të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid, i administruar nga Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H., për një afat të pacaktuar, dhe fillon veprimtarinë e tij më 07.05.2024 .

Neni 4 : Monedha bazë e Fondit Furnizues
Monedha bazë e Fondit Furnizues është Euro. Investimet dhe shlyerjet bëhen në Euro.

Neni 5 : Periudha kontabël
Viti financiar për Fondin Furnizues fillon më 01 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Neni 6 : Objekti i veprimtarisë së Fondit
Objekti i veprimtarisë së Fondit Furnizues është t'u mundësojë investitorëve të përfitojnë nga kthimi i Fondit Kryesor. Synimi i investimit të fondit janë të ardhurat e rregullta afatmesme. Fondi Furnizues kërkon të arrijë qëllimin e tij duke investuar të paktën 85% të aktiveve në kuota të Fondit Kryesor dhe të mbajë deri në 15% të aktiveve të veta në mjete monetare dhe depozita pa afat.

Neni 7 : Pjesëmarrja në Fond
7.1 Çdo person mund të blejë kuota në Fondin Furnizues duke hyrë në një marrëdhënie ligjore, me shoqërinë administruese;

7.2 Shoqëria administruese llogarit dhe publikon çdo ditë vlerën e kuotës. Llogaritja e vlerës neto të aseteve dhe çmimit të kuotës i nënshtrohet kontrollit dhe verifikimit nga depozitari, i cili është përgjegjës për saktësinë e llogaritjes;

7.3 Çdo investitor nënshkruan kontratën (Urdhërin) e blerjes së kuotave, duke konfirmuar se është njohur dhe ka rënë dakord me kushtet e përcaktuara në Prospektin dhe Rregullat e Fondit Furnizues .

Neni 8 : Të drejtat dhe përgjegjësitë e investitorëve në Fondin Furnizues
8.1 Investitorët në Fond kanë të drejtat e mëposhtme:
a. Të kenë pronësinë e kuotave dhe të pajisen me certifikatën e pronësisë
b. Mund të tërheqin fitimin nëpërmjet shitjes së plotë ose të pjesshme të kuotave
c. Të marrin pjesë në fitimet e Fondit Furnizues, proporcionalisht me pjesëmarrjen në të
d. Të informohen periodikisht (raporte vjetore, gjashtë mujore sipas kërkesës)
e. Të kërkojnë shitjen e pjesshme apo të plotë të kuotave në çdo kohë
f. Të kryejnë këmbim të kuotave midis fondeve të investimit të manaxhuara nga e njëjta shoqëri administruese.
g. Të transferojnë pronësinë e kuotave në fond
h. Në rast falimenti të shoqërisë administruese, asetet e tyre të jenë objekt i së drejtës së veçimit
i. Investitorët janë përgjegjës për detyrimet e Fondit deri në shumën e pjesëmarrjes së tyre në Fond
j. Nuk mbajnë përgjegjësi për veprimet ose mosveprimet e shoqërisë administruese ose depozitarit të fondit
k. Çdo kuotë e fondit i jep të drejtë të barabartë në sipërmarrje.

Neni 9 : Investimi minimal
Shuma minimale e investimit në Fondin Furnizues është 500 EURO. Vlera minimale e llogarisë për qëndrimin në Fondin Furnizues është 100 EURO. Nëse balanca e llogarisë mbetet më e vogël se 100 EUR, llogaria mund të mbyllet. Në këtë rast, kuotat do të shlyhen me çmimin e aplikueshëm në ditën e mbylljes.
Shoqëria administruese nuk ka vendosur kufizime për investimin maksimal në Fondin Furnizues.

Neni 10: Shlyerja e kuotave
10.1 Investitorët kanë të drejtë të kërkojnë në çdo kohë shitjen e kuotave të tyre;

10.2 Investitorët nënshkruajnë një kërkesë për shitje të kuotave në fondin furnizues;

10.3 Shlyerja e kuotave në Fondin Furnizues bëhet nga Shoqëria Administruese jo më vonë se 7 ditë kalendarike nga data e mbërritjes së një kërkese të vlefshme për shitje me përjashtim të rasteve kur Shoqëria Administruese, në mbrojtje të interesave të investitorëve ka aktivizuar shtyrjen e afatit të shlyerjes si mjet i manaxhimit të likuiditetit të parashikuar në seksionin 3.4.1 të Prospektit.

Neni 11: Karakteristika të kuotave të Fondit
Kuotat e Fondit Furnizues janë kuota akumulimi. Kjo do të thotë që të ardhurat nga investimi ri-investohen automatikisht dhe përfitimet për investitorët vijnë nëpërmjet rritjes së vlerës së kuotave. Fitimi realizohet në momentin që investitori shlyen pjesërisht ose plotësisht kuotat në Fondin Furnizues.

Neni 12: Tarifat
12.1 Shoqëria administruese do të aplikojë një komision vjetor administrimi për të gjithë investitorët në fond, i cili do të jetë deri në 1.30% në vit e vlerës neto të aseteve të Fondit.

12.2 Për çdo shlyerje apo këmbim të kryer përpara përfundimit të periudhës minimale të investimit prej 2 vitesh, për investimin përkatës, do të aplikohet një tarifë dalëse deri në 1.00%, e cila përllogaritet si përqindje e shumës së shlyer/këmbyer. Nga kjo tarifë përjashtohen investitorët që transferojnë kuotat e tyre tek një apo disa investitorë të tjerë brenda të njëjtit fond. Për përfituesin e kuotave nga transferimi, i cili është investitor ekzistues në fond, periudha minimale e investimit prej 2 vitesh do të llogaritet nga data e përfitimit të kuotave të transferuara.

12.3 Shpenzimet e mëposhtme do t'i ngarkohen Fondit Furnizues: kostot e transaksionit, shpenzimet për auditorin, tarifat rregullatore, tarifat dhe kostot e depozitarit/tarifat e kujdestarisë dhe nënkujdestarisë, kostot e komunikimit të ndryshimeve në fletëpalosje dhe komunikimet e tjera të përshkruara. Keto shpenzime në asnje rast nuk mund të kalojë 3,5% në vit të vlerës neto të aseteve të fondit

12.4 Shpenzimet e mëposhtme do t'i ngarkohen mbajtësit të kuotave : kostot e lëshimit të certifikatave të transaksionit ose vërtetime mbi pronësinë e kuotave, tarifa për transferimin, kostot e shpërndarjes së raporteve sipas kërkesës së investitorit.

12.5 Çdo ndryshim i tarifave që do të aplikohet nga shoqëria administruese, do t'u njoftohet investitorëve të paktën 2 muaj përpara, sipas procedurave të përcaktuara në Ligj dhe prospektin e Fondit Furnizues.

Neni 13: Shoqëria administruese
13.1 Shoqëria administruese e Fondit Furnizues është Raiffeisen Invest sh.a. - Shoqëri administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive.

13.2 Raiffeisen Invest është një shoqëri aksionare me seli në Rr.Abdyl Frashëri, EGT Tower, Pall.11/1, Kati 3, Tiranë, Shqipëri e themeluar më datë 18.07.2005 me Vendimin nr.33825 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

13.3 Kapitali i regjistruar i shoqërisë është 90.000.000 (nëntëdhjetëmilionë) lekë.

13.4 Raiffeisen Invest sh.a. mbikëqyret nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, dhe ka si objekt të aktivitetit të saj: Veprimtarinë e administrimit të fondeve të pensionit privat dhe aseteve të sipërmarrjes së investimeve kolektive, mbështetur në licencën me nr.1, datë 13.12.2011, lëshuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

13.5 Raiffeisen INVEST sh.a. administron fondet e mëposhtme:
1. Fondin e investimit Raiffeisen Prestigj
2. Fondin e investimit Raiffeisen Invest Euro
3. Fondin e investimit Raiffeisen Vizion
4. Fondin e Pensionit me Pjesëmarrje të hapur Raiffeisen
5. Fondin e investimit Raiffeisen Miks
6. Fondin Furnizues të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid

Neni 14: Detyrimet e Shoqërisë Administruese
Shoqëria administruese gjatë administrimit të Fondit Furnizues ka detyrimet e mëposhtme:
a. Të administrojë Fondin Furnizues në përputhje me objektivat e investimit të parashikuara në prospekt;
b. Të blejë asetet, në emër dhe për llogari të Fondit Furnizues, duke i depozituar ato te një depozitar i vetëm;
c. Të organizojë shitjen e kuotave të Fondit Furnizues sipas procedurave të përcaktuara në Ligj dhe prospekt;
d. Të shlyejë në kohën e duhur dhe në mënyrë të vazhdueshme të gjitha detyrimet monetare;
e. Të informojë periodikisht investitorët, sipas prospektit;
f. Të garantojë ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave nën administrim.

Neni 15: Trajtimi fiskal i fondit dhe investitorit
15.1 Fondi Furnizues për qëllime tatimi, konsiderohet si pronari i titujve ose i të gjitha aseteve, si dhe personi i fundit që përfiton prej saj, përveçse kur parashikohet ndryshe në legjislacionin tatimor.

15.2 Të gjitha fitimet e realizuara nga investimi në Fondin Furnizues do të tatohen sipas legjislacionit tatimor në fuqi, në momentin e shlyerjes së kuotave. Tatimi mbahet në burim nga shoqëria administruese.

Neni 16: Depozitari
16.1 Shoqëria administruese ka lidhur një kontratë me Bankën e Parë të Investimeve, Albania sh.a., me seli në adresën Bul. "Dëshmorët e Kombit", Kullat Binjake, Kulla 2, Kati 14, Tiranë, e cila në përputhje me Ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive", do të ofrojë shërbimet e depozitarit për asetet e Fondit.

16.2 Pjesë përbërëse e rregullave të Fondit Furnizues është Deklarata e Kujdestarisë së Depozitarit.

Neni 17: Kontabiliteti
Shoqëria administruese përgatit pasqyrat financiare dhe raportet e tjera financiare në përputhje me legjislacionin dhe standardet e pranuara të SNRF.

Neni 18: Auditimi
18.1 Shoqëria administruese bën të mundur që pasqyrat financiare të kontrollohen nga ekspertët kontabël të autorizuar të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

18.2 Audituesi i jashtëm i fondit është RSM Albania Sh.p.k.

Neni 19 : Konfidencialiteti dhe Mbrojtja e të dhënave personale
19.1 Raiffeisen invest sh.a, siguron konfidencialitetin në lidhje me informacionin e klientit dhe të dhënat e llogarisë.

19.2 Raiffeisen invest sh.a, është e detyruar të raportojë këtë lloj informacioni vetëm me kërkesë të organeve / institucioneve që e kanë këtë të drejtë në përputhje me Legjislacionin Shqiptar.

Neni 20 : Miratimi dhe ndryshimi i Rregullave të Fondit Furnizues
20.1 Rregullat e Fondit Furnizues miratohen nga Këshilli i Administrimit të shoqërisë administruese.

20.2 Rregullat e Fondit Furnizues i bashkëlidhen prospektit dhe përbëjnë pjesë integrale të tij.

20.3 Ndryshimet dhe shtesat në rregullat e Fondit Furnizues do të miratohen nga Këshilli i Administrimit si dhe do të marrin miratimin e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare në përputhje me dispozitat e Ligjit.

Neni 21: Dispozita të Fundit
21.1 Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga zbatimi apo interpretimi i këtyre rregullave, do të zgjidhet bazuar në legjislacionin shqiptar.
21.2 Rregullat e Fondit Furnizues do të hyjnë në fuqi në datën e miratimit nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare.

Aneksi 2
Deklarata e kujdestarisë

Bazuar në Ligjin nr.56/2020 "Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive" në cilësinë e Depozitarit për Fondin e Qëndrueshëm "Raiffeisen Solid",

Deklaroj:
Pasuria e sipërmarrjes së investimeve kolektive, do të ruhet nga Depozitari për llogari të investitorëve, duke respektuar parimin e barazisë, në përputhje me numrin e kuotave që zotëron çdo investitor, ose në rastin kur ekzistojnë njëkohësisht si kuota të ardhurash, ashtu edhe kuota akumulimi, në përputhje me pjesën individuale në pasurinë e sipërmarrjes, e llogaritur në bazë të kuotave të zotëruara nga çdo investitor;

Shumat, që ndodhen në llogarinë e parave për t'u shpërndarë, mbahen nga Depozitari vetëm për qëllime shpërndarjeje.

Monedha bazë e Fondit është Euro.

Viti Financiar i Fondit fillon më 01 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Depozitari: BANKA E PARË E INVESTIMEVE, ALBANIA SH.A.

Përfaqësuesi/t i/e Autorizuar

Aneksi 3
Formular tip i blerjes së kuotave në Fondin e Qëndrueshëm Raiffeisen Solid

Informacion i rëndësishëm

1. *Çdo investitor duhet te lexojë me kujdes Prospektin dhe Rregullat e Fondit Furnizues, me qëllim që të ketë një informacion të qartë mbi karakteristikat, risqet dhe tarifat, përpara marrjes së vendimit për të investuar në Fondin e Qëndrueshëm "Raiffeisen Solid". Prospekti i bashkëlidhet ketij Urdhëri dhe është pjesë përbërëse e tij.*
2. *Ju lutemi plotësoni të gjithë seksionet e këtij Urdhëri (ku janë të aplikueshme).*
3. *Investimi Juaj do të kryhet menjëherë pas mbërritjes së pagesës në llogarinë e Fondit.*
4. *Raiffeisen Invest sh.a do të mundësojë pajisjen me username dhe PIN, për të kontrolluar transaksionet / gjendjen në Fondin e Qëndrueshëm Raiffeisen Solid bazuar në kërkesën e investitorit;*
5. *Raiffeisen Invest sh.a konverton investimin e klientit në kuota, në momentin që pagesa mbërrin në llogarinë e Fondit të Qëndrueshëm "Raiffeisen Solid"në Bankën Depozitare-Banka e Parë e Investimeve,Albania sh.a*
6. *Për çdo shlyerje apo këmbim të kryer përpara përfundimit të periudhës minimale të investimit prej 2 vitesh, do të aplikohet një tarifë dalëse prej 1% mbi vlerën e shlyer/këmbyer.*

***Dokumentacioni i kërkuar**

Urdhëri për blerje kuotash në Fondin e Qëndrueshëm Raiffeisen Solid shoqërohet detyrimisht me dokumentacionin identifikues (kartë identiteti/pasaportë të vlefshme) si dhe adresën e vendbanimit tuaj!Për detaje të mëtejshme, lutemi referojuni web-site të Shoqërisë www.raiffeisen-invest.al. Kërkesa juaj nuk mund të procesohet pa informacionin e mësipërm.

***Detaje mbi fondin e investimit:**

Emri i Fondit: Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid

Çmimi i Kuotës do të jetë çmimi i zbatueshëm në ditën e mbërritjes së pagesës në llogarinë e Fondit. Çmimi përllogaritet në perputhje me Ligjin 56/2020, «Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive » dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

I Informacion mbi investitorin

Emri: _____ Atësia: _____ Mbiemri: _____

Gjinia: Femër ☐ Mashkull ☐

Datëlindja: ___/___/_____Vendlindja: _____ Shtetësia: _____

Dokumenti i Identifikimit nr. _____Nr. personal: _____

Autoriteti lëshues: _____Data e lëshimit: ___/___/_____Data e skadimit:___/___/_____

Shteti ku paguan taksat: _____ Adresa e Vendbanimit: _____

Adresa e korrespondencës: _____ Tel: _____

e- Mail: _____ I punësuar në: _____ Pozicioni i punës _____

II Informacion mbi personin e tretë që investon në emër të investitorit

Emri: _____ Atësia: _____ Mbiemri: _____

Gjinia: Femër ☐ Mashkull ☐

Datëlindja: ___/___/_____Vendlindja: _____ Shtetësia: _____

Dokumenti i Identifikimit: _____

Autoriteti lëshues: _____Data e lëshimit: ___/___/_____Data e skadimit:___/___/_____

Adresa e Vendbanimit: _____

Adresa e korrespondencës: _____ Tel: _____

e- Mail: _____ I punësuar në: _____ Pozicioni i punës _____

III Mënyra e investimit

1. Pagesë e menjëhershme 2. Plan investimi

Në rastin e planit të investimit, frekuenca e kryerjës së pagesave do të jetë :

Mujore ☐ Tremujore ☐

Shuma e investuar_____

Kohëzgjatja e parashikuar e investimit_____

**Në rastin kur Investitori zgjedh një plan investimi, do të aplikohen kushtet dhe tarifat në fuqi të fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid.*
Përveç sa më sipër, në mënyrë të veçantë, do të aplikohen kushtet në vijim:

1. *Investitori duhet të respektojë frekuencën e zgjedhur të kryerjes së pagesave;*
2. *Shuma minimale e investimit në planin e investimit është 50 Euro;*
3. *Investitori në çdo kohë ka mundësi të rrisë ose zvogëlojë shumën e investuar ;*
4. *Investirori nënshkruan formularin e autorizimit për pagesë periodike pranë çdo dege të Raiffeisen Bank sh.a, duke përcaktuar shumën, frekuencën dhe datën e kryerjes së pagesës. Një kopje e formularit i bashkëlidhet Urdherit të blerjes së kuotave.*

IV Burimi të ardhurave

Lutemi konfirmoni burimin e të ardhurave për këtë transaksion_____

**Deklaroj nën pergjegjësinë time se investimi i fondeve, do të shërbejë vetëm për qëllime të ligjshme dhe njëkohësisht burimi i tyre është nga një aktivitet i ligjshëm.*

V Deklaratë e investitorit:

Unë deklaroj se, kam marrë, lexuar, kuptuar si dhe kam rënë dakord me Dokumentin me Informacionin Kryesor për Investitorin (KIID), Prospektin dhe Rregullat e Fondit të Qëndrueshëm Raiffeisen Solid, i administruar nga Raiffeisen INVEST sh.a. Shqipëri , i licencuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare si Fond furnizues i Fondit Kryesor Raiffeisen-Nachhaltigkeit-Solide (Fondi i Qëndrueshëm Raiffeisen Solid) i administruar nga Raiffeisen Kapitalanlage-Gesellschaft m.b.H., me seli në Vjenë, Austri.

Deklaroj,se kam lexuar,kuptuar dhe plotësuar pyetsorin e rrezikut dhe jam njohur me profilin tim të rrezikut. Jam i vetëdijshëm që ky lloj investimi nuk është i garantuar. Nënshkrimi i këtij Urdhëri nënkupton hyrjen në një marrëdhënie ligjore me Raiffeisen INVEST sh.a. Ky investim është bërë vetëm sipas dëshirës dhe gjykimit tim, dhe se jam në dijeni dhe kam kuptuar kushtet e ofertës, të gjitha rreziqet e përfshira si dhe tarifat që lidhen me blerjen dhe shitjen e kuotave në Fondin e Qëndrueshëm Raiffeisen Solid.

Kuptoj se të dhënat e mia personale të deklaruara në këtë Urdhër Blerje dhe/ose në çdo dokument tjetër (formular/kontratë) të nënshkruar apo deklaruar pranë Raiffeisen Invest sha, janë të dhëna të detyrueshme, të cilat do të përpunohen nga kjo e fundit me standardet me të larta të sigurisë si dhe konform parashikimeve ligjore në fuqi, vetëm për qëllimin e ofrimit të produkteve/ ose për të përmbushur një detyrim ligjor që Raiffeisen Invest sha mund të ketë, bazuar në aktet ligjore dhe rregullative në Republikën e Shqipërisë. Kuptoj se mbetet detyrim i imi të përditësoj këto të dhëna, sa here që do të ndryshohen.

Gjithashtu, deklaroj se jam njohur me faktin se kam të drejtë, që në çdo kohë, me anë të një kërkese paraprake me shkrim, t'i kërkoj Raiffeisen Invest sha, që të korrigjojë,apo të fshijë të dhënat e mia personale.

VI Përpunimi i të dhënave personale

Deklaroj se informacioni i dhënë nga ana ime në këtë Urdhër Blerje është i vërtetë dhe i saktë.

Unë shpreh pëlqimin tim që Raiffeisen INVEST sha, të mbledhë të dhënat e mia personale apo të personave të tretë deklaruar nën përgjegjësine time,në këtë Urdhër Blerje, si edhe t'i përpunojë më tej ato vetëm për qëllimin e ofrimit të shërbimit për të cilin po aplikoj. Kuptoj se çdo e dhënë personale lidhur me personin tim do të trajtohet me një nivel sigurie të stadardeve me të larta në përputhje të plotë me parashikimet e ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 i cili zëvendësohet me Ligjin nr.124/2024 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij,si edhe në përputhje me parashikimet e bëra në "Rregulloren e Përgjithshme Europiane Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" GDPR.

Gjithashtu, deklaroj dhe jap miratimin tim për procesimin e mëtejshëm të të dhënave personale nga ana e Raiffeisen INVEST sha, duke i transferuar këto të dhëna drejt palëve kontraktore të cilat mund të jenë në cilesinë e përpunuesit në kuadër, të celjes, mirëmbajtjes dhe administrimit të llogarisë. Në këtë kuadër, jepet në mënyrë të shprehur pëlqimi që Raiffeisen Invest sha, të mund të përcjellë çdo formë KYC, dhe të gjithë informacionin përfshirë në të , si dhe gjithë dokumentat që kam vënë në dispozicion për verifikim ose që i janë vënë dispozicion RBI-së lidhur me procedurat KYC të saj, për marrësit e renditur më poshtë (Marrësit):

- anëtarë të grupit RBI në Austri ose brenda BE-së
- anëtarë të grupit RBI në vende të treta jashtë territorit të BE-së
- anëtarë të tjerë të Raiffeisen Banking Group

Çdo përcjellje e tillë do të kufizohet vetëm për marrësit me të cilët ka aktualisht një marrëdhënie biznesi ose që ka qëllim të lidhet një marrëdhënie biznesi.Kjo bëhet vetëm me qëllim përmbushjen e kërkesave KYC të marrësit pa u kërkuar të vëmë në dispozicion informacion dhe dokumentacion shumë herë".

Jam njohur me faktin që të dhënat e mia personale i transferohen subjektit Banka e Parë e Investimeve sh.a, në cilësinë e Depozitarit të fondit bazuar në Ligjin nr. 56/2020 "Për sipërmarrjet e Investimeve kolektive", subjektit Raiffeisen Bank Sha, Shqipëri, si dhe CRISP Centralised Raiffeisen International Services & Payments S.R.L me seli në Bukuresht- Rumani.

Autorizoj në mënyrë të parevokueshme Raiffeisen Invest Sh.a, të përpunojë, transferojë dhe të trajtojë, të gjitha të dhënat e mia personale dhe financiare të deklaruara prej meje, të tashme dhe të ardhme, tek Autoriteti Fiskal në SH.B.A "Internal Revenue Service"-"IRS", Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shqipëri, shoqëritë mëme apo çdo palë tjetër që mund të jetë e nevojshme, vetëm për qëllim të realizimit dhe implementimit të FATCA dhe CRS (në zbatim të Ligjit 4/2020 "Për shkëmbimin automatik të informacionit"), nëse dhe sa herë që kërkohet. Të dhënat subjekt i këtij përpunimi dhe transmetimi janë: Gjeneralitet, Adresa, Numri Identifikimit Fiskal, Numri dhe Balanca e Llogarisë/Llogarive në fond, në një moment të caktuar ose në çastin e mbylljes së llogarisë/llogarive në fond, si dhe çdo informacion shtesë të kërkuar nga IRS dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Shqipëri.

Autorizoj në mënyrë të shprehur Raiffeisen INVEST sha, që të ruajë të dhënat e mia personale për një afat deri në 11- vite pas mbylljes së marrëdhënies së biznesit mes meje dhe shoqërisë. Jam njohur nga shoqëria me faktin që për çdo pyetje apo informacion lidhur me mënyrën e përpunimit të të dhënave të mia personale kam të drejtë të dërgoj e-mail në adresën elektronike: rbal.dataprotection@raiffeisen.al.

Gjithashtu, kuptoj se bazuar në dispozitat e GDPR dhe Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, unë mund të ushtroj në çdo kohë të drejtën për akses, të drejtën për të kërkuar bllokimin, korrigjimin ose fshirjen e të dhënave personale që perpunohen nga ana e Raiffeisen INVEST sha. Gjithashtu në çdo kohë ruaj të drejtën për t'u ankuar tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale" dhe ruaj të drejtën për t'u tërhequr nga dhënia e pëlqimit për përpunim e të dhënave.

Investitori/personi tretë **Agjenti shitës i autorizuar**

_____ _____

<u>Miratimi për përpunimin e të dhënave personale në rast ofertash promocionale</u>

Jap miratimin tim të pakushtëzuar që Raiffeisen INVEST sha,të përdorë të dhënat e mia personale për marketing direkt, informimin për fushata të ndryshme, me qëllimin e përfitimit nga ana ime të ofertave promocionale, si pjesë e paketës së produkteve/shërbimeve që Shoqëria ofron(apo do të ofrojë në të ardhmen),nëpërmjet një ose disa prej kanaleve të informimit,duke përfshirë por pa u kufizuar në: i) postë zyrtare ii)sms iii)telefonatë iv) postë elektronike etj.

Deklaroj se jam venë në dijeni që dizenjimi i ofertave individuale do të bëhet nëpërmjet procesit të profilizimit që përfshin analizë të automatizuar të të dhënave personale për të konkluduar mbi nevojat ekonomike ose financiare, përgjegjësinë time financiare dhe karakteristika të tjera të cilat analizohen për të krijuar ofertat individuale.

Në këtë kuadër autorizoj Raiffeisen INVEST sha, që duke respektuar standardet me të larta të sigurisë,si dhe bazuar në dispozitat ligjore dhe rregullative në fuqi,të delegojë përpunimin e mëtejshëm të të dhënave të mia personale,duke i transferuar këto të dhëna tek palë të treta të specializuar për këtë qellim. Në këtë kuadër, të dhënat e mia personale mund të përdoren dhe shkëmbehen edhe mes anëtarëve dhe partnerëve të grupit Raiffiesen brenda dhe jashtë vendit me qëllim që të më sigurojnë informacion lidhur me ofertat e tyre. Lista e tyre mund t'ju vihet në dispozicion bazuar në kërkesë.

Gjithashtu,deklaroj se jam njohur me të drejtën që në çdo kohë të kërkoj nga Shoqëria revokimin e këtij miratimi.

Unë pranoj ☐ **Unë nuk pranoj** ☐

Data e paraqitjes së kërkesës ___/___/_____ Vendi_____

Investitori/personi tretë **Agjenti shitës i autorizuar**

Emër Mbiemër /firmë Emër Mbiemër /firmë

(Vulë)

_____ _____

Publikuar në **Tetor 2026**